SHLUJ "UNIVERSITETI MARIN BARLETI"

SHKOLLA E LARTË UNIVERSITARE JOPUBLIKE
"UNIVERSITETI MARIN BARLETI"

RAPORT
I
VLERËSIMIT TË BRENDSHËM
PËR PROGRAMIN E STUDIMIT
MASTER PROFESIONAL NË EDUKIM ME PROFIL DREJTIM DHE ADMINISTRIM I ARSIMIT

Shkurt, 2015

PËRMBAJTJA

- **INFORMACIONI KRYESOR PËR SHLUJ UMB DHE PROGRAMET MASTER TË OFRUARA PREJ SAJ**
- **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM**
- **PARIMET E PUNËS SË GVBC**
- **REZULTATE TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM PËR PROGRAMIN "MASTER PROFESIONAL NË EDUKIM ME PROFIL DREJTIM DHE ADMINISTRIM I ARSIMIT"**
  - **PROGRAMI I STUDIMEVE, ADMINISTRIMI NË SHËRBIM TË MISIONIT TË NJËSISË**
  - **POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE**
  - **POLITIKA E KËRKIMIT SHKENCOR**
- **PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME**
  - **ANALIZA SWOT**
  - **REKOMANDIME**
- **SHTOJCA**

SHKURTIME

APAAL	Agjencia Publike e Akredimit të Arsimit të Lartë
DAA	Drejtim Administrim Arsimi
EDU	Edukim
GVBC	Grupi i Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë
FSHS	Fakulteti i Shkencave Sociale
LAL	Ligji për Arsimin e Lartë
MAS	Ministria e Arsimit dhe e Sportit
MP	Master i Profesional
NJSBC	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
SHLUJ	Shkolla e Lartë Universitare Jopublike
UMB	Universiteti "Marin Barleti"

- **INFORMACIONI KRYESOR PËR SHLUJ UMB DHE PROGRAMET MASTER TË OFRUARA PREJ SAJ**

STATUSI I SHLUJ UMB

SHLUJ UMB është institucion privat i arsimit të lartë, që është krijuar në bazë të Ligjit Nr. 8461, datë 25.02.1999, i ndryshuar, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe në bazë të VKM Nr. 571, datë 12.08.2005 "Për dhënin e lejës për hapjn e Shkollës së Lartë Univrsitare jopublike "Universiteti Marin Barleti" dhe funksionon në bazë të Ligjit Nr.9741, datë 21.5.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar me ligjet Nr. 9832, datë 12.11.2007, Nr. 10 307, datë 22.7.2010, Nr. 1 0 493, datë 15.12.2011 dhe aktet nënligjore të dala në bazë të tij.

Ky institucion filloi veprimtarinë mësimore gjatë vitit akademik 2006-2007.

Me daljen e ligjit nr.9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republiken e Shqipërisë" (i ndryshuar), programet e ofruara nga SHLUJ UMB u përshtatën sipas kërkesave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore, si dhe në përputhje me parimet e Procesit të Bolonjës.

Me urdhërin Nr.288 datë 04.09.2009 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, SHLUJ UMB ka fituar akreditimin institucional dhe akreditimin e programeve të studimit: BA në Menaxhim Biznesi, BA në Financë-Kontabilitet, BA në Shkenca Politike, BA në Drejtësi.

Me urdhërin Nr. 329 datë 07.08.2012 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, SHLUJ UMB ka fituar akreditimin e programeve të studimit: MP në Administrim Biznesi me profil Financë-Kontabilitet, MP në Administrim Biznesi me profil: Shërbime Bankare dhe Financiare, MP në Administrim Biznesi me profil Marketing dheMenaxhim Operacionesh, MP në Administrim Biznesi me profil: Lidership dhe Menaxhim Burimesh Njerëzore, MP në Shkenca Politike me profil: Administrim Publik, MP në Shkenca Juridike me profil: E drejtë Biznesi/Tregtare, MP në Shkenca Juridike me profil E Drejtë Publike.

VIZIONI, MISIONI DHE ZHVILLIMI STRATEGJIK I SHLUJ UMB

SHLUJ UMB ka zhvilluar projektin e vet strategjik në sfondin e veprimtarisë kombëtare në arsim për zgjerimin e demokratizimit dhe reformës institucionale me vështrim ndaj modernizimit dhe pranimit të plotë në Evropë. Ai pohon përparësitë e forcimit të qytetarisë, zhvillimin dhe mobilizimin e njohurive, si dhe rëndësinë e angazhimit në tregjet e reja për të siguruar konvergjencën e ekonomisë shqiptare në tranzicion.

Në kontekstin shqiptar, SHLUJ UMB dallohet përsa i përket synimit për të kombinuar principet e shkollës liberale klasike me idealet e tij për opinion të pavarur kritik dhe mendimin e lirë, me cilësitë themelore të mendjes dhe shpirtin e sipërmarrësit, që mund të shfrytëzohen për të nxitur përparime personale dhe profesionale, si dhe duke parë e duke iu afruar botës në një mënyrë që vërtet ndihmon të tjerët. Duke ofruar degë dhe profile, duke përfshirë stazh dhe përvojë praktike pune në industri dhe tregti, diplomat e SHLUJ UMB kombinojnë sfidën akademike me trajnimin dhe aftësitë që do t'i pajisin studentët për punësim në të ardhmen, si dhe t'i lejojnë ata të jenë ambasadorë të fuqishëm për Shqipërinë në shoqërinë evropiane e më gjerë.

SHLUJ UMB operon si një institucion i pavarur i arsimit të lartë. Si i tillë, ai është i paangazhuar politikisht dhe synon të punojë për të mirën e shoqërisë në disa mënyra të ndërlidhura:

- si një mjet për përftimin e njohurive dhe krijimin e kapitalit të qëndrueshëm intelektual;
- si një mik kritik me kapacitet akademik i qeverisjeve, për të vlerësuar dhe udhëzuar politikën;
- si një burim për gjenerimin dhe mbështetjen e zhvillimit shoqëror dhe ekonomik;
- si një burim për kultivimin e idealeve dhe vlerave demokratike.

Vizioni i SHLUJ UMB është që të shndërrohet në një universitet të nivelit të lartë duke bashkuar edukimin demokratik dhe liberal me shpirtin e sipërmarrjes në gjithçka që bëjmë. Ne synojmë të mendojmë globalisht duke kultivuar vetëdijen ndërkombëtare dhe duke nxitur një kulturë të re dhe krijuese të nxënies. Ne jemi njësoj të angazhuar të veprojmë si brenda vendit, ashtu edhe sipas nevojave rajonale për të mbrojtur një të

ardhme të qëndrueshme duke ndihmuar për një ekonomi më të përparuar dhe një shoqëri më të drejtë, që i nxit njerëzit të realizojnë qëllimet e tyre.

Misioni i SHLUJ UMB është forcimi i trashëgimisë dhe reputacionit në drejtim të përpjekjeve shkencore për të krijuar një model të arsimit të lartë që kombinon standardet akademike me aplikimet e botës reale. Ne punojmë të jemi një institucion proaktiv me vështrim nga e ardhmja, që u përgjigjet shpresave për ndryshim, modeleve të nxënies dhe mundësive për shkëmbimin e dijes në frymë bashkëpunimi. Të udhëhequr nga vlerat dhe të përqendruar te njerëzit, do të përdorim njohuritë që krijojmë për të ndryshuar perspektivat e jetës së brezave të studentëve, duke kontribuar kështu për një shoqëri produktive dhe të begatë. Këtë do ta arrijmë duke paraqitur një ofertë akademike elastike dhe të mbështetur nga epërsia në mësimdhënie dhe nxënie, duke krijuar një përvojë aktive të studentëve, kërkim shkencor të aplikuar me njohje dhe ndikim brenda vendit, shërbime me vështrim ndaj biznesit dhe sipërmarrjes, duke luajtur një rol kyç në zhvillimin e rrjeteve që mbështesin lidhjet ndërkombëtare përmes partnerëve dhe bashkëpunëtorëve tanë.

Synimet dhe objektivat

SHLUJ UMB ka një strategji disavjeçare për avancimin e synimeve dhe qëllimeve të mishëruara në vizionin dhe misionin e saj dhe e pozicionon veten si një institucion i përparuar i arsimit të lartë në rajonin e Evropës Juglindore. Strategjia përfshin gjerësisht ndjekjen e temave kryesore me rëndësi strategjike për sukses në të ardhmen. Këto tema strategjike identifikohen dhe shprehen nëpërmjet një sërë ambiciesh të ndërlidhura.

Ambicia 1 - KULTURA

Të krijohet një kulturë akademike e besueshme, që sigurohet përmes një bashkëpunimi dhe partneriteti ku vlerësohen larmia, krijimtaria dhe risia, ku ushqehen dhe përhapen idetë dhe ku shpërblehen rezultatet.

Ambicia 2 – STUDENTËT

Të përhapet një përvojë studentore e shquar, duke formuar studentë universitarë dhe pasuniversitarë që janë ambiciozë, të pavarur, studiues me iniciativë, të përgatitur mirë përmes përvojës së tyre për të mësuar nga jeta, nga realitetet e sferës së profesionit dhe nga mundësitë që sjell evropianizimi.

Ambicia 3 – PUNA KËRKIMORE

Të mbështetet dhe të çohet më tej puna kërkimore e një standardi më të lartë në fushat kyçe me ndikim në shoqëri dhe në ekonomi, të promovohet bashkëpunimi në punën kërkimore, të inkurajohen dhe të përkrahen kërkimet e reja në mësimdhënie dhe nxënie dhe të nxitet shpirti i kërkimit dhe komunikimit.

Ambicia 4 – RAJONI

Të jetë forcë akademike drejtuese brenda Shqipërisë dhe më gjerë në rajonin e Evropës Juglindore, duke ndikuar për një ekonomi që shikon nga e ardhmja, që bazohet në dije të qëndrueshme dhe duke promovuar një shoqëri qytetarësh mendjemprehtë, të aftë dhe plot jetë.

Ambicia 5 – NDËRKOMBËTARIZIMI

Të rriten mundësitë, emri dhe reputacioni ynë përmes ndërkombëtarizimit – procesit të integrimit të një dimensioni ndërkombëtar, ndërkulturor dhe global në qëllimet, funksionet dhe përhapjen e arsimit të lartë – duke zhvilluar kështu kulturën tonë krahas asaj ndërkombëtare, duke çuar përpara evropianizimin dhe duke siguruar kapacitete më të mëdha për angazhim global.

Ambicia 6 – QËNDRUESHMËRIA

Të përsoset më tej ekspertiza në zhvillimin e qëndrueshëm dhe të përfshihen aktivitete për edukimin e qëndrueshëm në kurrikulën e universitetit, duke siguruar që të diplomuarit tanë të jenë të mirëarsimuar dhe të vetëdijshëm për çështjet mjedisore, sociale dhe etike.

Ambicia 7 – PROFESIONALIZMI NË SIPËRMARRJE

Të edukojë dhe të mbështesë tek të gjithë të diplomuarit shpirtin e sipërmarrjes dhe aftësinë për të shfrytëzuar teknologjinë e re, të nxisë perspektivat e komunitetit të biznesit dhe të ofrojë edukim dhe trajnim mbi bazën e përvojës, që i pajisin praktikantët profesionistë me dijet dhe aftësitë që iu nevojiten për të përparuar profesionalisht, t'u sjellin dobi të tjerëve dhe të krijojnë mundësi të reja.

Ambicia 8 – SIPËRMARRJA SHOQËRORE

Të kooperohet me partnerët kryesorë për zhvillimin e përgjegjësisë shoqërore përmes aktiviteteve sipërmarrëse shoqërore dhe korrekte moralisht, duke çuar përpara punën tonë në komunitet dhe duke promovuar një veprimtari aktive të re, që siguron përfshirjen e shoqërisë.

Ambicia 9 - INFRASTRUKTURA

Të sigurohet që të gjitha strategjitë, politikat dhe sistemet të mundësojnë dhe të përshpejtojnë angazhimin tonë për të qenë një universitet i transformimeve dhe që krijon struktura të përgjegjshme dhe elastike, të cilat shfrytëzojnë plotësisht teknologjitë e reja dhe përkrahin ndryshimin pozitiv.

SHLUJ UMB ka përcaktuar planin afatshkurtër dhe planin afatmesëm të zhvillimit. Në kuadrin e planit afatshkurtër synohet:

- *Në aspektin akademik*

Të ngrihet e të zhvillohet më tej:

- *Shkolla e Sociologjisë, Psikologjisë dhe Edukimit* duke e zgjeruar në nivelin pasuniversitar;
- *Shkolla e Politikës, Qeverisjes dhe Komunikimi*t duke zgjeruar, ndër të tjera, lidhjet e saj ndërkombëtare, partneritetin dhe kooperimin strategjik;
- *Shkolla e Shkencave Kompjuterike dhe Teknologjisë së Informacionit (Informatikë)* me oferta shtesë në aplikimin e teknologjive të reja të informacionit dhe komunikimit.
- Të zhvillohet dhe të zgjerohet më tej *Shkolla e Biznesit, Menaxhimit dhe Turizmit* me një shtesë të plotë departamentesh dhe një komplet programesh për nxënien profesionale, të pranuara në rang ndërkombëtar.
- Të hapet *Shkolla e Inxhinierisë* dhe *Shkolla e Arkitekturës, Ndërtimit dhe Planifikimit*.

B. Në aspektin kërkimor

SHLUJ UMB synon të krijojë dhe të mbështesë një profil kërkimor cilësor që arrin të njihet dhe të dallohet përmes inovacionit ndërdisiplinor të integruar, i përshtatshëm dhe i zbatueshëm në kontekstin rajonal. Për këtë arsye, strategjia kërkimore e universitetit përvijohet në pesë objektivat e ndërlidhura:

- Të vazhdojë rritja e kapaciteteve dhe aftësive kërkimore dhe të zhvillohet një infrastrukturë efektive për këtë qëllim.
- Të vazhdojë zhvillimi i një mjedisi dhe kulture kërkimore të qëndrueshme dhe të dobishme për studentët dhe stafin.
- Të vazhdojë zhvillimi i bashkëpunimit strategjik në punën kërkimore, në kooperim me institucione të tjera të arsimit të lartë dhe qendra të shquara kërkimore që kanë interesa dhe qëllime të përbashkëta.
- Të përmbushen kërkesat e certifikatave të njohura kombëtare dhe ndërkombëtare, që vërtetojnë cilësinë dhe ndikimin e përpjekjeve kërkimore.
- Të sigurohen lidhje dhe bashkëveprime efektive ndërmjet veprimtarive kërkimore, sipërmarrëse dhe të mësimdhënies.

C. Administrim

SHLUJ UMB do të krijojë *Akademinë Profesionale "Barleti" (BPA)* si një organizatë me shumë tipare për të gjitha aktivitetet e veta të mësimdhënies, trajnimit dhe formimit të vazhdueshëm profesional. BPA do të koordinojë studimet e duhura profesionale dhe të aplikuara universitare dhe pasuniversitare, TVET, shërbimet e testimit dhe programet e trajnimit dhe formimit të vazhdueshëm profesional, si dhe do të lidhet nga afër me organizma profesionale, shoqata dhe punëdhënës.

- *Sipërmarrje*

SHLUJ UMB do të nisë *Sipërmarrjen 'Barleti' sh.a.* si degën e vet të shërbimit, që ofron një sërë produktesh, shërbimesh, aktivitetesh komerciale dhe organizime ngjarjesh. Ajo do të lidhet në rrjet me degë të tjera të grupit "Dudaj" për të fuqizuar infrastrukturën plotësuese dhe për t'i siguruar kapacitet plotësues aktivitetit sipërmarrës.

Në plotësimin e vizionit dhe misionit të vet, duke iu referuar veçanërisht realizimit të ambicieve strategjike për profesionalizëm në sipërmarrje dhe për ndërmarrje shoqërore, SHLUJ UMB ka nisur disa projekte strategjike

që do ta çojnë edhe më përpara aftësinë e saj infrastrukturore për të qenë një institucion transformues i arsimit të lartë që plotëson lidhjen mes kërkimit, sipërmarrjes dhe inovacionit. Si pjesë të një projekti ambicioz zhvillimi, që përfshin një godinë moderne në kampusin 1, universiteti do të krijojë *Barleti Vistas TechnoPark*. Duke parashikuar një "urë ndërmjet universitetit dhe botës reale", është menduar që ai të pasqyrojë një qendër për zhvillimin e biznesit dhe do të përfaqësojë inkubatorin e parë sipërmarrës për biznesin e teknologjisë së lartë në Shqipëri. The Business Start-Up & Incubator Centre (BSIC).

STRUKTURA E SHLUJ UMB

Në strukturën e SHLUJ UMB përfshihen katër fakultete, një akadmi, dy institute dhe katër qendra. Struktura e universitetit përbëhet nga një matricë me dy ndarje akademike që integrojnë funksione akademike, kërkimore, administrative dhe sipërmarrëse, për të krijuar platforma të përbëra për një sërë veprimtarish dhe shërbimesh që mbështesin misionin e universitetit. Njëra ndarje fokusohet gjerësisht në shkencat social-ekonomike dhe tjetra në shkencat e aplikuara.

Fakulteti i Ekonomisë dhe Financës ka si qëllim t'u transmetojë dije studentëve nëpërmjet cilësisë së lartë në mësimdhënie dhe punës kërkimore në fushat e financës dhe ekonomiksit. Fakulteti synon të krijojë një profil të veçantë të tijin si një qendër e njohur e ekspertizës shumëdisiplinore në ekonomi dhe në fushat financiare, me qëllime praktike dhe sociale. Strategjia e Fakultetit përqendrohet në përmirësimin e sistemit të programeve *bachelor* dhe atyre *master*, në mënyrë që studentët që diplomohen të hyjnë dhe të qëndrojnë në tregun e punës, zhvillimin e programeve kërkimore me organizimin e tyre në fusha prioritare, ndërkombëtarizimin e mëtejshëm të programeve akademike nëpërmjet programeve të këmbimit dhe realizimin e programeve të përbashkëta me partnerët strategjikë.

Fakulteti i Drejtësisë përfaqëson një nga fakultetet kryesore të universitetit dhe ka si qëllim aktivizimin e subjekteve akademike dhe specialistëve nga më të njohurit për realizimin e një formimi modern në fushën e drejtësisë dhe ligjit, në përputhje me standardet evropiane dhe përvojat e vendit, duke zbatuar specifikat përkatëse në lidhje me arsimin ligjor.

Fakulteti i Shkencave Sociale është një fakultet i ri dhe elitë, që ofron mundësi për studime sociale dhe politike, për punë kërkimore dhe zhvillim kulturor në kontekstin e gjerë të dukurive të shumëllojshme shoqërore. Misioni i fakultetit realizohet nëpërmjet zhvillimit efektiv dhe të plotë të programeve bachelor dhe master në shkenca politike, administrim publik, psikologji, sociologji dhe edukim.

Fakultetit të Shkencave të Aplikuara synon të promovojë dhe avancojë njohuritë profesionale e praktike, si dhe një etike të veçantë në angazhimin që mbështet zhvillimin e kapaciteteve kolektive të nevojshme për të nxitur mirëqenien e koorporatave. Vizioni dhe misioni i tij do të realizohen nëpërmjet zhvillimit të efektshëm të programeve bachelor dhe atyre master në fushat kryesore, si: administrim dhe menaxhim biznesi, informatikë e aplikuar, arsimim profesional dhe zhvillim i qëndrueshëm, turizëm, mjedis dhe inxhinieri.

Akademia Profesionale "Barleti" (BPA) parashikon zhvillimet e të mësuarit gjatë gjithë jetës. Ajo vepron si një organizatë përfaqësuese, duke koordinuar dhe ndërmjetësuar funksione që mbështesin një gamë të gjerë të nxënies së orientuar drejt profesionit dhe edukimit e trajnimit profesional. Kjo akademi do t'i pajisë studentët dhe të diplomuarit me aftësi për të marrë përsipër detyra sfiduese qysh në fillimet e karrierës së tyre profesionale dhe që do t'i ndihmojnë të hyjnë në shtigjet e një karriere të suksesshme.

SHLUJ UMB ka edhe këto institute dhe qendra

- *Instituti Shqiptar për Çështjet Publike (AIPA)* është njësi e orientuar kryesisht për studimin e politikave dhe është ngritur mbi një kuadër ndërdisiplinor, që përbëhet nga shkencat shoqërore, studimet ligjore dhe mjedisore.
- *Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit "Barleti" (BIRD)* ka si funksion kryerjen dhe promovimin me cilësi të lartë të kërkimeve shkencore të aplikuara.
- *Qendra e Ekselencës në Mësimdhënie dhe të Nxënë (CETL)*
- *Qendra e Inovacionit dhe Zhvillimit të Sipërmarrjes (EDIC)*

- *Qendra për Gjuhët dhe Kulturat Moderne*
- *Qendra për Informacion, Teknologji dhe Multimedia.*

Organet drejtuese të SHLUJ UMB-së janë:

- *Bordi Drejtues* është organ qeverisës i universitetit, njeh mirëqeverisjen si sistem dhe proces që lidhet *me drejtimin e përgjithshëm, efektivitetin, mbikëqyrjen dhe kontabilitetin e një organizate.* Bordi është krijuar për të mbikëqyrur ecurinë e universitetit dhe për të promovuar sukseset e tij. Anëtarët e tij janë figura të rëndësishme aktive në shoqërinë shqiptare dhe shumica e tyre kanë profil ndërkombëtar. Bordi është ngarkuar të veprojë në përputhje me Statutin e Universitetit dhe ta ushtrojë pushtetin e vet vetëm për qëllimet për të cilat ky pushtet i është akorduar. Individualisht ose kolektivisht, anëtarët e Bordit japin gjykime të pavarura në interes të universitetit, si dhe tregojnë kujdes të arsyeshëm, maturi financiare, aftësi dhe zell në interes të aksionarëve dhe palëve të interesuara të universitetit.
- *Rektorati* vepron nën udhëheqjen e rektorit të universitetit, i cili ka përgjegjësinë për drejtimin e përditshëm të universitetit, si dhe për të siguruar se ka një menaxhim efektiv dhe kontroll të standardeve akademike, përvojës së studentëve dhe zhvillimit institucional. Rektorati përfshin zyrat e prorektorit për çështjet akademike, prorektorit për studimet shkencore, prorektorit për çështjet studentore dhe administratorit te deleguar.
- *Senati akademik* është organ kolegjial vendimmarrës, që përcakton politikat e zhvillimit të institucionit, programon, bashkërendon, drejton dhe kontrollon veprimtaritë e mësimdhënies e të kërkimit shkencor dhe vlerëson efikasitetin e tyre.
- *Këshilli i Fakultetit* është organ kolegjial vendimmarrës, që programon e përcakton, në bazë të propozimeve të departamenteve, përdorimin e burimeve njerëzore dhe materiale në dispozicion të fakultetit. Ai propozon për programe të reja studimi ose të kërkimit shkencor; për hapje, ndryshim ose mbyllje departamentesh ose njësish të tjera; merr vendime për problemet financiare të fakultetit, në përputhje me autoritetin që i është deleguar atij; shqyrton dhe miraton raportin vjetor të dekanit për veprimtarinë mësimore dhe kërkimin shkencor. Këshilli i fakultetit i propozon senatit akademik planin strategjik të zhvillimit të fakultetit dhe mbikëqyr realizimin e tij.

Autoritetet drejtuese që veprojnë në SHLUJ UMB janë:

- Rektori
- Zv.rektori
- Administratori i Deleguar
- Dekani
- Drejtori i Institutit
- Përgjegjësi i Departamentit/Qendrës së Kërkimit dhe Zhvillimit

PROGRAME TË OFRUARA NGA SHLUJ UMB

SHLUJ UMB ofron këto programme.
Në ciklin e parë të studimeve ofrohen këto programme BA me 180 kredite:

- BA në Menaxhim Biznesi
- BA në Financë-Kontabilitet
- BA në Shkenca Politike
- BA në Psikologji
- BA në Sociologji
- BA në Drejtësi
- BA në Informatikë e Aplikuar

- BA në Administrim biznesi.
- BA Edukim fizik dhe Sporte
- BA në Financë Bankë Sigurime
- BA në Kontabilitet, Auditim dhe Taksa
- Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë në Arkitekturë (5 vjeçare/ 300 kredite)

Në ciklin e dytë të studimeve ofrohen këto programe:

Master Profesional me 60 kredite në fushat:
- *Shkenca Politike*: Administrim Publik, Lidership
- *Shkenca Juridike*: E Drejtë Publike, E Drejtë Biznesi/Tregtare
- *Administrim biznesi*: Financë-Kontabilitet; Shërbime Bankare dhe Financiare, Marketing dhe Menaxhim Operacionesh, Prona të paluajtshme dhe sigurime, Lidership dhe Menaxhim Burimesh Njerëzore
- *Komunikim*: Gazetari Ekonomike, Komunikim Publik
- *Edukim*: *(Mësimdhënie dhe Nxënie, Lidership dhe Administrim Arsimi)*

Master Profesional me 90 kredite në fushat:
- *Shkenca Politike*: Administrim Publik, Lidership
- *Shkenca Juridike*: E Drejtë Publike, E Drejtë Biznesi/Tregtare
- *Administrim biznesi*: Financë-Kontabilitet; Shërbime Bankare dhe Financiare, Marketing dhe Menaxhim Operacionesh, Prona të paluajtshme dhe sigurime, Lidership dhe Menaxhim Burimesh Njerëzore
- *Komunikim*: Gazetari Ekonomike, Komunikim Publik

Master i Shkencave me 120 kredite në fushat:
- *Shkenca Politike*: *Studime Evropiane*: (Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci; Politika Evropiane dhe Administrim Publik, Studime Ekonomike Evropiane, E Drejta Evropiane)
- *Drejtësi:* E Drejtë Publike, E Drejtë Tregtare, E Drejtë Penale dhe Kriminologji, E Drejtë e Pronësisë Intelektuale
- *Komunikim:* Studime në Gazetari, Studime në Gazetari Ndërkombëtare, Marrëdhënie me Publikun në Nivel Ndërkombëtar
- *Kontabilitet- Financë*: (Menaxhim Financiar; Shërbime Financiare Bankare, Taksimi dhe Ligji, Kontabilitet)
- *Menaxhim Biznesi*: (Logjistikë dhe Menaxhim Operacionesh; Marketing Strategjik, Menaxhim i Burimeve Njerëzore; Menaxhim i Sistemit të Informacionit)

Si rezultat i një bashkëpunimi ndërmjet SHLUJ UMB dhe Universitetit Clemson, është mundësuar ofrimi i Programit të UC "*PhD në Studime Ndërkombëtare për familjen dhe komunitetin"*. Në këtë bashkëpunim SHLUJ UMB ofron shërbimet logjistike dhe administrative.

- **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM**

Në plotësim të detyrimeve ligjore që dalin nga Ligji Nr.9741, datë 21.5.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar me ligjet Nr. 9832, datë 12.11.2007, Nr. 10 307, datë 22.7.2010, Nr. 1 0 493, datë 15.12.2011 dhe aktet nënligjore të dala në bazë të tij; në përputhje me "Standardet shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë të institucioneve të arsimit të lartë", miratuar nga MAS më 21.03.2011 si dhe bazuar në rekomandimet e Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe në "Udhëzuesin për Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë në Arsimin e Lartë" të publikuar prej saj; SHLUJ UMB më datë 21.11.2012 ka paraqitur pranë Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë kërkesën "Për nisjen e procedurës së akreditimit të studimeve "Master Profesional në

Edukim me profil "Drejtim dhe Administrim i Arsimit" dhe ka kryer procesin e vlerësimit të brendshmëm, i cili përfundon me Raportin e Vlerësimit të Brendshëm si dhe materialet mbështetëse të këtij raporti.

OBJEKTI I VLERËSIMIT

Vlerësimi i brendshëm i Programit "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit".

QËLLIMI

Vlerësimi i brendshëm synon të analizojë cilësinë e programit të studimit "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" i ofruar nga SHLUJ UMB me qëllim që të sjellë përmirësime dhe të shërbejë si një burim informacioni për vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin.

PËRBËRJA E GRUPIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË

Për realizimin e procesit të vlerësimit të brendshëm, me urdhër të Rektorit të SHLUJ UMB u ngrit Grupi i Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë (GVBC). Në përzgjedhjen e anëtarëve të GVBC u mbajtën parasysh kritere të tilla, si: kompetencat profesionale, përvoja në arsimin e lartë, përvoja në fushën e vlerësimit të cilësisë në arsim, paanshmëria, aftësitë për grumbullimin e informacionit për të kryer vlerësimin, aftësitë për punën në ekip, përfaqësimi i e balancuar i sa më shumë zërave të institucionit.

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë përbëhet nga:

- Dr. Robert Gjedia –pedagog, përgjegjës i vlerësimit të cilësisë të studimeve master ,
- Msc/Drnt. Migena KAPLLANAJ, pedagoge, Zyra e Cilësisë për Studimet Master
- Prof.Dr.Gëzim Hadaj, pedagog i shkencave të edukimit
- Msc. Eurona LEKA, pedagoge në programet e studimeve evropiane
- PhD. Edita Fino, pedagoge në shkencat sociale
- Luesta METANI, studente e programit master.

ROLI I GVBC

GVBC ka marrë përsipër:

- Të kryejë një vlerësim të brendshëm i kërkuar nga SHULP UMB dhe APAAL si pjesë e procesit të vlerësimit të brendshëm dhe e aplikimit për akreditim të programeve MSH të ofruara nga SHLUJ UMB në periudhën 2011-2015.
- Të kryejë një vlerësim formues për të sjellë përmirësime.
- Të përgatisë instrumente për realizimin e vlerësimit.
- Të përgatisë raportin përfundimtar.

ASPEKTE TË VLERËSIMIT

Vlerësimi është përqendruar në aspektet e përcaktuara në dokumentin "Standardet Shtetërore të Cilësisë për Vlerësimin dhe Akreditimin e Programeve të Studimit të Ciklit të Dytë të Institucioneve të Arsimit të Lartë", miratuar nga MAS më 21.03.2011, të renditura si më poshtë:

- Programi i studimeve, administrimi në shërbim të misionit të njësisë

- Politikat e formimit të studentëve
- Politika e kërkimit shkencor

BURIMET, INSTRUMENTET DHE PROCEDURA E MBLEDHJES SË INFORMACIONIT

Vlerësimi i brendshëm bazohet në informacionin e mbledhur nga burimet e mëposhtme:

- Dokumentacioni ligjor dhe i politikave institucionale, si:
  - Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë,
  - Standardet Shtetërore të Cilësisë për Vlerësimin dhe Akreditimin e Programeve të Studimit të Ciklit të Dytë,
  - Statuti i SHLUJ UMB,
  - Rregullorja e SHLUJ UMB,
  - Plani i zhvillimit strategjik të SHLUJ UMB
  - Rregullore e Programit MSH;
- Dokumentacioni pedagogjik, si:
  - Programi i Studimit "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit"
  - Plani mësimor
  - Programet lëndore,
  - Paketa e Provës Finale,
  - Paketa e Praktikës;
- Baza e të dhënave për programin e studimit;
- Baza e të dhënave për studentët;
- Baza e të dhënave për personelin pedagogjik dhe administrativ;
- Baza e të dhënave për infrastrukturën;
- Punime të studentëve;
- Formularë të vlerësimit të studentëve për mësimdhënien;
- Formularët e vlerësimit të programeve të studimit dhe programeve lëndore;
- Intervista me drejtues, pedagogë, studentë;
- Raporte të vetëvlerësimit të drejtuesve të SHLUJ UMB.

PROCEDURA E VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Për të realizuar procedurën e vlerësimit të brendshëm të programit në fjalë, SHLUJ UMB u konsultua me APAAL në lidhje me vlerësimin e programeve Master dhe u mbështet në përvojën e fituar nga procedura e akreditimit institucional dhe të programeve Bachelor dhe Master Profesional.

Vlerësimi i brendshëm ka ndjekur disa faza: a) të përgatitjes së metodologjisë dhe instrumenteve të vlerësimit, b) të mbledhjes së të dhënave, c) të analizës së të dhënave, d) të shkrimit të raportit dhe e) të komunikimit të rezultateve.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së SHLUJ UMB bëri një plan pune, ndau detyrat dhe udhëzoi secilin anëtar të grupit të vlerësimit për përmbushjen e detyrave.

Për hartimin e këtij raporti, GVBC organizoi takime me stafin akademik (të brendshëm dhe të jashtëm), takime me studentët. Gjithashtu u shfytëzuan të gjitha materialet, të dhënat që kishte SHLUJ UMB, vlerësimet e kryera nga studentët për procesin mësimor, për stafin akademik, për infrastrukturën.

- **PARIMET E PUNËS SË GVB**

Për realizimin e vlerësimit të brendshëm dhe hartimin e këtij raporti, GVBC u mbështet në parimet e mëposhtme:

- **Besueshmëria**

Gjetjet janë të besueshme, pasi ato janë bazuar në tregues dhe prova të besueshme.

- **Profesionalizmi**
  Anëtarët e GVBC zotërojnë përvojë pune në arsimin e lartë, ekspertizë dhe kompetenca në fushën e vlerësimit

arsimor që e garantojnë cilësinë e procesit të vlerësimit.

- **Integriteti/Ndershmëria**

GVBC garanton ndershmërinë dhe integritetin e procesit të vlerësimit në tërësi, konsistencën e veprimeve, vlerave, metodave.

- **Pavarësia**

Parimi i pavarësisë është manifestuar në garantimin e pavarësisë së gjykimit që do të thotë se përfundimet e vlerësimit nuk janë ndikuar dhe nuk janë marrë nën presion nga një palë tjetër.

- **Paanësia**

Vlerësimi paraqet një tablo të balancuar të pikave të forta dhe të dobta të aspekteve të vlerësuara. Procesi i vlerësimit demonstron paanësi në të gjitha etapat e tij: në takim me pedagogët, studentët, administratën, të interesuarit, në analizën dhe prezantimin e gjetjeve.

- **Transparenca**

Sipas këtij parimi, dokumentet e SHLUJ UMB dhe raporti i vlerësimit të brendshëm janë lehtësisht të lexueshëm dhe të disponueshme për të gjitha palët e interesuara.

- **REZULTATE TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM PËR PROGRAMIN "MASTER PROFESIONAL NË EDUKIM ME PROFIL DREJTIM DHE ADMINISTRIM ARSIMI"**

Rezultatet e vlerësimit të brendshëm janë pasqyruar sipas dokumentit « Standardet Shtetërore të Cilësisë për Vlerësimin dhe Akreditimin e Programeve të Studimit të Ciklit të Dytë". Për secilin standard dhe kriter GVBC ka paraqitur treguesit sasiorë dhe cilësorë, ka paraqitur argumente, ka bërë interpretime dhe është shprehur për nivelin e plotësimit të standardeve.

- **PROGRAMI I STUDIMEVE, ADMINISTRIMI NË SHËRBIM TË MISIONIT TË NJËSISË**

- **Misioni dhe Objektivat e programit të studimit**

<u>Pjesa përshkrimore</u>

Programi " Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" i është nënshkruar procedurës së vlerësimit paraprak në APAAL, është hapur bë bazë të Urdhërit Nr. 549 datë 11.11.2011 të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencëc. Programi është i organizuar në lëndë mësimore, të cilat janë të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

Programi "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" synon t'i përgatisë individët për pozicione drejtuese në arsim dhe si specialist të politikës arsimore duke i pajisur me aftësitë për të drejtuar institucione dhe programe arsimore; për të ideuar politka arsimore, për t'u bërë lehtësues të ndryshimit arsimor; për të zbatuar metoda të reja për të zgjidhur problemet që ndesh arsimi. Ky program nuk është vetëm një program studimi, por edhe një program zhvillimi që i ndihmon studentët të zhvillojnë aftësitë që atyre u duhen për t'u bërë drejtuesit dhe politikëbërësit më të mirë.

Programi "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" përputhet me strategjinë e zhvillimit të institucionit pasi ai është konceptuar në përputhje me vizionin për të plotësuar misonin dhe objektivat strategjikë. Përputhja shihet në disa aspekte: a) programi master është ndërtuar mbi synimet e programeve bachelor në shkenca sociale; b) plotëson synimin për të përgatitur specialistë të zotë për drejtimit të arsimit për tregun e punës brenda vendit dhe në rajon; c) ësht konceptuar si një model që kombinon standardet akademike me aplikimet e botës reale; d) është konceptuar si një model që kombinon mësimin me kërkimin, e) paraqet një ofertë akademike elastike që ndërtohet duke mbajtur parasysh kërkesat e tregut, përvojën aktive dhe interesat e studentëve; f) i përgatit studentët për të kontribuar për një ekonomi më të zhvilluar, shoqëri më të drejtë; f) ka të integruar dimensionin ndërkombëtar.

Programi "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" i pajis studentët me njohuri teorike dhe praktike.

Programi ka përcaktuar këto objektiva
- të ofrojë një formim teorik të specializuar në fushën e politikës, drejtimit dhe administrimit të arsimit;
- të formojë kompetenca për përmbushjen e rolit të drejtuesit në arsim;
- të zhvillojë aftësi të kërkimit shkencor në fushën e politikës arsimore, të drejtimit dhe administrimit të arsimit.

Programi synon që studentët në përfundim të studimeve të zotërojnë kompetencat të cilat janë të pasqyruara në Rregulloren e Studimeve.

Kompetenca të përgjithshme
- për të drejtuar dhe menaxhuar;
- për të komunikuar me një regjistër të avancuar profesional;
- për të analizuar;
- për të vlerësuar dhe reflektuar për çështje të drejtimit dhe të administrimit të arsimit;
- për të qenë krijues.

Kompetenca specifike
- për të kuptuar problematikën që lidhet me politikën arsimore, me drejtimin dhe administrimin e arsimit, të shkollës;
- për të menaxhuar burimet humane, materiale, financiare;
- për të zgjidhur problemet;
- për të përdorur kërkimin në kontekst arsimor;
- për të hartuar dokumente të planifikimit strategjik.

Kompetenca të transferueshme
- të shkruajnë dokumente të politikës arsimoret;
- të përdorim burime dhe teknologji informacioni;
- të marrin pjesë në debate, diskutime;
- të vlerësojnë në mënyrë kritike evidenca;
- të zhvillojnë aftësi negociimi;
- të zhvillojnë aftësitë e reflektimit.

Programi është bazuar në përvojat më të mira vendase dhe të huaja dhe i përgjigjet kërkesave të tregut të punës.

Programi "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" ndiqet nga 14 studentë. Në këtë program japin mësim 7 pedagogë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret		Vlerësimi sipas standardit/ kriterit
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.		
Kriteri 3 **Kriteri 4** **Kriteri 5** **Kriteri 6**	Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit; Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës; Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit; Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	Misioni i programit të studimit përputhet me qëllimet dhe misionin e institucionit. Programi "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" synon t'i përgatisë individët për pozicione drejtuese në arsim dhe si specialist të politikës arsimore duke i pajisur me aftësitë për të drejtuar institucione dhe programe arsimore; për të ideuar politka arsimore, për t'u bërë lehtësues të ndryshimit arsimor; për të zbatuar metoda të reja për të zgjidhur problemet që ndesh arsimi. Ky program nuk është vetëm një program studimi, por edhe një program zhvillimi që i ndihmon studentët të zhvillojnë aftësitë që atyre u duhen për t'u bërë drejtuesit dhe politikëbërësit më të mirë. Programi i studimit është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës. SHLUJ UMB ka bërë një studim të tregut nëpërmjet pyetësorëve dhe ka arritur në përfundimin se drejtimi ni arsimit është një program i kërkuar veçanërisht nga drejtuesit në detyrë të shkollave dhe nga ata që synojnë të punojnë në drejtim. Programi mban parasysh zhvillimin ekonomik të vendit dhe perspektivën e zhvillimit ekonomik të vendit si perspektivën e integrimit evropian, e theksuar kjo edhe për arsyen se kjo SHLUJ UMB ka në fokus programet e shkencave sociale. Programi i studimit pasqyron vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit. Në programin që vlerësohet kjo realizohet përmes përfshirjes në programin e lëndëve të temave dhe rasteve që trajtojnë vlerat dhe përvojën më të mirë të drejtimit të arsimit shqiptar.
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.		
Kriteri 1	Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;	Programi "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" është ndërtuar duke mbajtur parasysh strategjinë për zhvillimin e institucionit dhe ambiciet e shprehuara në këtë dokument. Programi ka përcaktuar objektiva që përputhen me strategjinë e zhvillimit të institucionit, objektiva që janë të shprehur qartë, të realizueshëm dhe të matshëm. Programi "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" përputhet me strategjinë e zhvillimit të institucionit gjë që shihet në disa aspekte: a) programi master është ndërtuar mbi synimet e programeve bachelor në shkenca sociale; b) plotëson synimin për të përgatitur specialistë të zotë për drejtimit të arsimit për tregun e punës brenda vendit dhe në rajon; c) është konceptuar si një model që kombinon standardet akademike me aplikimet e botës reale; d) është konceptuar si një model që kombinon mësimin me kërkimin, e) paraqet

		një ofertë akademike elastike që ndërtohet duke mbajtur parasysh kërkesat e tregut, përvojën aktive dhe interesat e studentëve; f) i përgatit studentët për të kontribuar për një ekonomi më të zhvilluar, shoqëri më të drejtë; f) ka të integruar dimensionin ndërkombëtar.
Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.		
Kriteri 1 **Kriteri 2**	Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi; Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.	Programi "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" është ndërtuar mbi bazën e kritereve të përcaktuara nga Ligji për Arsmin e Lartë, nga Udhëzimet e MAS dhe të APAAL. Ky kriter është mbajtur parasysh që në momentin e hartimit të programit të studimit. Programi "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" i përket nivelit 7 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimit.
Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.		
Kriteri 1 **Kriteri 2**	Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve; Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.	SHLUJ UMB ka një plan të zhvillimit strategjik të IAL dhe ka parashikuar politikën e zhvillimit të programeve të studimeve master. Informacioni i siguruar nga monitorimi dhe vlerësimi formues e ka ndihmuar Departamentin Sociologji, Psikologji, Edukim të parashikojë zhvillimin e mëtejshëm të programit të studimit master që mbulon. SHLUJ UMB ka një plan të zhvillimit strategjik të IAL-së ku parashikohet edhe përmirësimi i mësimdhënies.
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u> **Bazuar në dokumentacionin që zotëron SHLUJ UMB, rezulton se ky institucion ka një plan të zhvillimit strategjik, ka përcaktuar vizionin dhe misionin të cilët janë artikuluar qartë. Misioni i SHLUJ UMB është i shprehur në dokumentin e Planit të Zhvillimit Strategjik, ndërsa misioni i Programit "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" është i shprehur në Rregulloren e Studimeve të këtij programi. Misioni i institucionit ngërthen disa aspekte: ofertën akademike elastike, kërkimin shkencor të aplikuar, përvojën aktive të studentëve, shërbimet me vështrim ndaj drejtimit të arsimit, të gjitha këto për të kontribuar për një ekonomi më të përparuar dhe një shoqëri më të drejtë. Misioni i Programit "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" përputhet plotësisht me misonin e SHPUL UMB, përputhje që pasqyrohet në 7 aspekte dhe që synon pajisjen me njohuri të thelluara teorike dhe praktike, si dhe aftësimin për kërkim shkencor në fushën e financës, në profilin kontabilitet. Ky program është ndërtuar dhe ofruar në përputhje me legjislacionin parësor dhe dytësor në fuqi.** **Standardet e paraqitura më lart janë përmbushur tërësisht.**		

- **Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)**

  <u>Pjesa përshkrimore</u>

Fakulteti i Shkencave Sociale është një fakultet i ri dhe elitë, që ofron mundësi për studime sociale dhe politike, për punë kërkimore dhe zhvillim kulturor në kontekstin e gjerë të dukurive të shumëllojshme shoqërore.

Misioni i fakultetit realizohet nëpërmjet zhvillimit efektiv dhe të plotë të programeve bachelor dhe master në shkenca politike, administrim publik, psikologji, sociologji dhe edukim.

Ky Fakultet përbëhet nga tre departamente:
a. Departamenti Qeverisje, Politika, Komunikim
b. Departamenti Sociologji, Psikologji, Edukim
c. Qendra e Ekselencës në Mësimdhënie dhe të Nxënë

Departamentin Sociologji, Psikologji, Edukim ka përgjegjësinë e drejtpërdrejtë për programin "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit".

Departamenti i Sociologjisë, Psikologjisë dhe Edukimit realizon programe studimi në nivelin Bachelor, në Sociologji, Psikologji, Edukim Fizik dhe Sporte si dhe programe studimi të nivelit të dytë (Master) në Sociologji me profile: Zhvillim Social Komunitar dhe Zhvillim Ekonomik e Studim Tregu, në Psikologji Ligjore dhe në Edukim me drejtim "Mësimdhënie dhe të nxënët" dhe "Drejtim dhe Administrim Arsimi". Misioni i Departamentit të Sociologjisë, Psikologjisë dhe Edukimit është përgatitja e dyfishtë e studentëve: si profesionistë të aftë për të përballuar kërkesat e tregut të punës në një shoqëri të hapur e gjithnjë e më të integruar; si qytetarë aktivë të një shoqërie të re demokratike. Ai u referohet përvojave më të mira të institucioneve akademike të vendeve të zhvilluara, si dhe traditës më të mirë të mendimit shqiptar, themelues i të cilit është humanisti i shquar Marin Barleti. Programet e akredituara të studimit u përmbahen kërkesave të Ligjit për Arsimin e Lartë në RSH dhe përvojës së drejtpërdrejtë të universiteteve partnere nga bota.

Drejtimet bazë të departamentit janë sociologjia, psikologjia shkencat e edukimit dhe mësuesia të marra si fusha të shkencës dhe profesione.

Departament përbëhet nga 3 seksione:
A) Seksioni i Sociologjisë
Realizon programe studimi për përgatitjen e specialistëve të sociologjisë. Profesioni i sociologut është një profesion zyrtar, i miratuar dhe i përfshirë në Listën Kombëtare të Profesioneve të Republikës së Shqipërisë me nr. 2632. Programet e studimit janë ndërtuar në përputhje me tregun potencial të punës të specialistëve të kësaj fushe.
B) Seksioni i Psikologjisë
Seksioni i Psikologjisë i këtij departamenti realizon programe studimi për përgatitjen e specialistëve të psikologjisë. Profesioni i psikologut është një profesion zyrtar, i miratuar dhe i përfshirë në Listën Kombëtare të Profesioneve të Republikës së Shqipërisë me nr. 2635.01 Psikolog; 2635.02 Psikolog në arsim; 2635.04 Psikolog në shëndetësi.
C) Seksioni i Edukimit
Seksioni i Edukimit i këtij departamenti realizon programe studimi për specialistë në fushën e edukimit duke u fokusuar në të mësuarit e vazhdueshëm profesional për mësuesit, përmirësimin e shkollimit, praktikën profesionale, drejtimin dhe administrimin e arsimit si dhe hulumtimin dhe risitë për ndryshime pozitive në arsim.
Qëllimi i seksionit të Edukimit është të japë një kontribut të veçantë për modernizimin, fuqizimin e arsimit dhe përmirësimin e cilësisë së tij. Seksioni synon të arrijë këtë qëllim përmes zhvillimit dhe ofrimit të një modeli të qëndrueshëm të arsimit të vazhduar profesional gjatë gjithë jetës dhe trajnimit, që vepron në kuadër të sistemit të krediteve ECTS, që lidhet në mënyrë kritike me çështjet e arsimit urban dhe rajonal, ndërton kapacitetet në nivel lokal dhe institucional dhe mobilizon njohuritë përmes teknologjisë së re dhe ndërkombëtarizimit.

Këshilli i Fakultetit është organ kolegjial vendimmarrës i Fakultetit. Ai merr në shqyrtim dhe vendos për problemet më të rëndësishme të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe kualifikimit.

Këshilli i Fakultetit përbëhet deri në 9 anëtarë, të cilët zgjidhen nga personeli akademik i Fakultetit. Mandati i anëtarëve të Këshillit të Fakultetit është tre vjet. Anëtarët e Këshillit të Fakultetit përfaqësojnë personelin akademik të Fakultetit. Ata mund të jenë gjithashtu personel akademik i ftuar ose bashkëpunëtorë shkencorë

të jashtëm. Si rregull, në Këshillin e Fakultetit janë të përfaqësuar të gjitha departamentet dhe njësitë kërkimore-shkencore të Fakultetit. Anëtari zgjidhet me votim të anëtarëve të personelit të njësisë që ai përfaqëson.

Dekani është anëtar dhe Kryetar i Këshillit të Fakultetit për shkak të detyrës dhe e përfaqëson atë në marrëdhëniet me Senatin.

Tregues të matshëm:

- Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë: PAE, PAK, PA, titujt/gradat, (shih Tabelën 1)

Tabela 1

Fakulteti Shkencave Sociale	Departamenti Qeverisje, Politika, Komunikim							
	Numri i PAE		Numri i PAK		Numri i PA		Në Total	
	Gj	Titulj/ Grada	Gj	Titulj/ Grada	Gj	Titulj/ Grada	Gj	Titulj/ Grada
	4	Dr	1	DR				
	4	MSc	1	MSc				
	1	Prof. Asoc Dr	2	Prof. Dr.				
	Departamenti Sociologji, Psikologji, Edukim							
	3	Prof.dr	3	Prof. Asoc.Dr.				
	3	Dr	2	Dr.				
	4	Msc	3	MSc				

- Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinatori/ët e programit të studimit (shih Tabelën 2)

Tabela 2

Emër Mbiemër	Titulli/grada	Pozicioni në Këshillin shkencor
Saemira Gjipali	Dr.	Kryetare
Robert Gjedia	Dr.	Koordinator
Migena Kapllanaj	Dokt.	Anëtare

- Dokumentacioni përkatës
    - Statuti i UMB
    - Rregullore e UMB
    - Rregullore e Studimeve për Programin MP –EDU-DAA
    - Dosja e programit të studimit
    - Programet lëndore

- **Personeli akademik dhe mbështetës**

Pjesa përshkrimore

Stafi administrativ është i organizuar në nivel institucioni në dy struktura: për programet bachelor dhe për programet master.

Tregues të matshëm:

- Cilësia e stafit drejtues, mësimdhënës dhe administrativ për çdo njësi (plotëso Tabelën 3)

Tabela 3

Fakulteti i Shkencave Sociale -Departamenti Qeverisje, Politika, Komunikim							
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1	Zamira Çavo	Përgjegjëse dep.	Prof. Ass. Dr.	1	Paskal Milo	Prof. Dr.	
2	Reis Mulita	anëtar	PhD	2	Eralda Methasani	Prof. Asoc. Dr.	Këshilltare e Kryeministrit
3	Dorian Jano	anëtar	PhD	3	Shpëtim Cami	Dr.	
4	Ervis Martani	anëtar	PhD	4	Petrit Dollani	Dr.	UT
5	Eurona Leka	anëtar	MSc (Dokt)	5	Ilia Kristo	Prof. Dr.	UT
6	Erijon Kristo	anëtar	MSc (Dokt)	6	Lavdosh Ahmetaj	Dr.	
7	Fatjona Qurku	anëtar	MSc	7	Gjergji Dhima	MSc	
8	Xhuljeta Krasta		MSc (Dokt)				
Fakulteti i Shkencave Sociale Departamenti Sociologji, Psikologji, Edukim							
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1	Gëzim Hadaj	Përgjegjës dep.	Prof. Dr.	1	Marjana Çadri	Dr.	Ministria e Mbrojtjes
2	Edita Fino	anëtare	Dr.	2	Stavri Trako	Dr.	Pension

3	Saemira Pino	anëtare	Dr.	3	Erlira Koçi	Prof. Asoc. Dr.	Pension
4	Silvana Loka	anëtare	Msc. (Dokt)	4	Bashkim Peçi	Prof. Asoc. Dr.	
5	Enkelejda Hamzaj	anëtar	MSC (Dokt)	5	Nazim Shtino	Msc	Pension
6	Migena Kapllanaj	anëtar	MSC (Dokt)	6	Lekë Sokoli	Prof. Asoc. Dr.	Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës
7	Aida Hudhri	anëtar	MSc	7	Florian Kulla	Msc. (Dokt)	OJF,
8	Sokol Jareci	anëtar	MSc	8	Stavri Sinjari	Dr.	Kërkues i lirë
9	Alketa Caushaj	anëtare	Dr.				
10	Robert Gjedia	anëtar	Dr.				
11	Arben Bakllamaja	anëtar	Prof. Asoc. Dr.				

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (plotëso Tabelën 4)

Tabela 4

Titulli	Dep **Qeverisje, Politika, Komunikim**			Dep **Sociologji, Psikologji, Edukim**		
	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK
Profesorë	0	2	0/2	1	0	1/0
Profesorë të As.	1	1	1/1	1	3	1/3
Doktorë	3	3	3/3	4	3	4/3
Pedagogë (pa tituj)	4	1	4/1	5	0	5/0
Asistentë me MSc						
Asistentë pa MSc						
Personeli Administrativ						

- Të dhëna sipas moshës (plotëso Tabelën 5 dhe 6)

Personeli sipas titujve /gradave	Numri i PAE dhe PA me moshë:				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Profesorë					1
As. Prof				2	
Doktorë	2	1	2	2	
Pedagogë (pa tituj)	6	2	1		
Asistentë me Ma					
Asistentë pa Ma					
Personeli Administrativ					

Tabela 6

Personeli sipas titujve /gradave	Numri i PAK me moshë:				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Profesorë				1	1
As. Prof		1		3	
Doktorë		1	1		
Pedagogë (pa tituj)			1		
Asistentë me Ma					
Asistentë pa Ma					

- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Çdo anëtar i stafit akademik dhe administrativ nënshkruan në fillim të çdo viti akademik kontratën e punës me Administratorin e Deleguar, ku përcaktohen të gjitha detyrimet dhe të drejtat e palëve. (shih kopje kontrate në dosje) SHLUJ UMB ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit. Pjesë e vlerësimit të stafit referuar kontratave të personelit janë disa aspekte: mësimdhënia, kërkimi dhe kontributi në projekte. SHLUJ UMB ka një strukturë të posaçme të emërtuar Zyra e Burimeve Njerëzore, e cila ka krijuar një bazë të dhënash për personelin dhe vendet vakant të punës, që ndjek shpalljen e vendeve të lira, përpunimin e të dhënave etj. Kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë të përfshira në Statut për nivelet e larta të drejtimit (neni 28-30 i Statutit) ndërsa për stafin tjetër sipas nenit 23 të Statutit të UMB, është Bordi që miraton kriteret kryesore arsimore për stafin që rekrutohet. Ndërkohë kriteret propozohen në varësi të vendit vakand nga strukturat përkatëse (eprori i drejtpërdrejtë).

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret		Vlerësimi për Kriteret dhe standardet
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.		
Kriteri 1 **Kriteri 2**	Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre; Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	SHLUJ UMB ka kritere për pajtimin në punë të personelit të brendshëm dhe të jashtëm dhe përzgjedhja e tij është bërë në përputhje më këto kritere. Personeli i angazhuar në Programin "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" ka përmbushur objektivat dhe detyrat e parshikuara në kontratën e punës ose të shërbimit. Personeli akademik, ndihmës dhe administrativ i SHLUJ UMB-së ishte angazhuar në zbatimin e detyrave mbështetur në kontratën e punës. Personeli ka detyra për zbatimin e planit strategjik të zhvillimit të institucionit. Këto detyra janë të parashikuara në kontratë ose të dhëna sipas nevojave.
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.		
Kriteri 1 **Kriteri 2**	Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve; Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.	Personeli i Fakultetit të Shkencave Sociale është përfshirë në hartimin e zbatimin e kurrikulës. Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe rregullat e brendshme të SHLUJ UMB.
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.		
Kriteri 1 **Kriteri 2** **Kriteri 3** **Kriteri 4**	Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren; Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve; Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit; Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.	SHLUJ UMB ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit. Baza ligjore për rekrutimin e personelit përbëhet nga Ligji për Arsimin e Lartë, Kodi i Punës, aktet nëligjore të MAS, korniza rregullatore e UMB. Zyra e Burimeve Njerëzore e UMB është përgjegjëse për zbatimin e procedurave të rekturimit të personelit. Në Programin "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" 6 lëndë mbulohen nga pedagogë të brendshëm dhe 3 lëndë mbulohen nga pedagogë të jashtëm. Kuadri rregullativ i SHLUJ UMB përmban procedura transparente të vlerësimit të personelit. Zyra e Burimeve Njerëzore e UMB ka një bazë të dhënash (dosje personale aplikimi dhe punësimi, formularë vlerësmi, tabela staistikore) për të gjithë personelin.
Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.		
Kriteri 1	Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin "Profesor i asociuar" ose, gradën shkencore	Koordinatori i programit ka gradën shkencore Dr.

Kriteri 2 **Kriteri 3** **Kriteri 4** **Kriteri 5**	"Doktor" ("PHD") të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete; Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve "Master i Shkencave" ka të paktën gradën shkencore "Doktor"; Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve "Master profesional" ka të paktën gradën shkencore "Doktor" ose, diplomën "Master Profesional" ose "Master Shkencash" dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi; Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve; Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.	Në Programin "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" 1 titullar ka titullin "Profesor", 3 kanë titullin "Prof. Asoc." , 3 kanë gradën "Doktor". Rektori, prorektori, dekanët e fakulteteve, përgjegjësit e departamenteve dhe drejtorët e instituteve dhe të qendrave janë të punësuar me kohë të plotë në SHLUJ UMB. SHLUJ UMB ka personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.
Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.		
Kriteri 1 **Kriteri 2** **Kriteri 3**	Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli; Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore "Doktor"; Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.	Studentët që ndjekin Programin "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" kanë një udhëheqës për tezën. Departamenti ka një listë të udhëheqësve të miratuar. Lista dëshmon se është respektuar kriteri për udhëheqësin shkencor. Komiteti Shkencor është përgjegjës për caktimin e udhëheqësit të provës finale. Si rregull, udhëheqës i provës finale caktohet një pedagog i SHLUJ UMB, ose një bashkëpunëtor i SHLUJ UMB që mban titullin "Profesor", "Profesor i Asociuar", gradën "Doktor" që është njohës i mirë dhe kontribues i fushës nga e cila është përzgjedhur punimi që ai ngarkohet të udhëheqë. (Shiko listën në Shtojca) Në Programin "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit", udhëheqësit shkencorë nuk do të mbikëqyrin më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht.
Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.		
Kriteri 1 **Kriteri 2**	Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit. Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.	Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar dhe ka përvojë kërkimore udhëheqësi do të përputhet me temën që do të udhëheqë. Departamenti Sociologji, Psikologji, Edukim, bazuar në CV e pedagogëve, të vlerësimit të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe të përvojës së pedeagogëve ka gjykuar se udhëheqësit e miratuar të punimeve të diplomave për Programin "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" janë të përshtatshëm për udhëheqjen e punimeve dhe ata zotërojnë njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të

		veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.
Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.		
Kriteri 1 **Kriteri 2**	Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbatjen e laboratorëve e mjediseve shkollore; Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	SHLUJ UMB ka personel ndihmës për pajisjet e teknologjisë mësimore i cili u asiston si pedagogëve dhe studentëve dhe mirëmban gjithe rrjetin e internetit dhe pajisjet kompjuterike në laboratorin e informatikës. SHLUJ UMB ka pozicione të ndryshme pune për shërbimet dhe punonjësit e punësuar janë plotësisht të angazhuar për të përmbushur objektivat e programit.
Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.		
Kriteri 1 **Kriteri 2**	Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi; Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.	SHLUJ UMB, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, Kodi i Punës, Ligji për Arsimin e Lartë, Udhëzime të MAS dhe dokumentin e Politikës së Ngarkesës Mësimore ka përcaktuar ngarkesën mësimore si dhe elementet e tjerë të ngarkesës së punës. Ngarkesa mësimore e personelit është e llogaritur në orë mësimore sipas Dokumentit të Ngarkesës Mësimore të SHLUJ UMB.
Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.		
Kriteri 1 **Kriteri 2** **Kriteri 3**	Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit; Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ; Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.	SHLUJ UMB disponon një bazë të dhënash të hollësishme për personelin akademik të përfshirë në Programin "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" që përfshin dosjen personale, të dhënat për ngarkesën mësimore, të dhënat për kërkimin shkencor, të dhëna për pjesëmarrjen në projekte. Të dhënat disponohen të printuara dhe ekektronikisht. SHLUJ UMB disponon listën e plotë të personelit akademik që jep mësmim në Programi "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit". Zyra e Burimeve Njerëzore, Departamenti Sociologji, Psikologji, Edukim, Njësia e koordinimit të programeve master, Sekretaria mësimore e Masterave kanë informacion të plotë për personelin e angazhuar në realizimin e programit dhe periudhën kohore të realizimit të detyrave përkatëse. SHLUJ UMB i ka të përcaktuara dhe të publikuara kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit.
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u> **SHLUJ UMB ka hartuar një politikë dhe ka ngritur një sistem për menaxhimin e personelit të institucionit që përfshin: politikën dhe procedurat e rekrutimit, politikën dhe procedurat e vlerësimit të performacës së personelit, politikën dhe procedurat e promovimit të personelit, politikën dhe procedurat e menaxhimit të të**		

dhënave të personelit. Zbatimi i kësaj praktike ka mundësuar punësimin e personelit cilësor, maksimizimin e efektshmërisë së veprimtarisë së personelit dhe përdorimin lehtësisht të të dhënave. SHLUJ UMB ka një politikë të qartë dhe ka përdorur forma të ndryshme për kualifikimin e vazhdueshëm të personelit të tij duke kombinuar kualifikimin e organizuar me mbështetjen e kualifikimit individual. Standardet janë përmbushur.

Për realizimin e synimeve të Programit "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit", është angazhuar një ekip pedagogësh me grada dhe tituj, personel ndihmës dhe personel administrativ. Përzgjedhja e këtij personeli është bërë në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit, kriteret e rekrutimit të personelit dhe në përputhje me specifikën e programit.

Në përputhje me përgjegjësitë dhe të drejtat e parashikuara në Rregulloren e SHLUJ UMB dhe në Rregulloren e Programit "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit", personeli akademik angazhohet dhe luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programit të studimit, në procesin e zbatimit të politikave të zhvillimit të institucionit, në procesin e vlerësimit të brendshëm dhe të përmirësimit të cilësisë.

SHLUJ UMB ka respektuar standardin për cilësinë e personelit të angazhuar në programin Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Adminsitrim Arsimi". Të 7 pedagogët që japin mësmim në këtë program janë me grada dhe tituj. Standardet e personelit akademik janë përmbushur plotësisht.

- **Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

Pjesa përshkrimore

Për realizimin e programeve të studimit SHLUJ UMB ka dy kampuse. Në kampusin 1 janë të përqendruar kryesisht studimet bachelor dhe administrata, ndërsa në kampusin 2 studimet master. Në total ka një sipërfaqe të konsiderueshme përdorimi të destinuar për salla leksionesh, laboratore, zyra, hapësira parkimi, mjedise çlodhëse, hapësira të gjelbra, hapësira të lira qarkullimi. Në mbështetje të studentëve funksionojë shërbimi i fotokopjeve, mensa, biblioteka, Zyra e rekrutimit, Zyra e këshillimit, Klinika e Këshillimit Psiko-social, Mentorët e Grupeve, Prorektori i Studentëve, Dekani i studentëve etj.

Tregues të matshëm:

- Mjediset e fakultetit (plotëso Tabelën 7)

Tabela 7

Mjediset për Fakultetin/përgjegjës për programin e studimit		Sipërfaqja
Salla për leksione	25	1020
Klasa për seminare		
Salla për aktivitete promovuese	2	174
Salla për praktikë lëndore/ profesionale		
Laboratorë për lëndët		
Laboratorë informatike	4	143
Salla interneti	2	88
Salla për bibliotekë	2	70
Mjedis për fotokopjime, librari etj	2	8
Zyrë informacioni për studentët	4	48
Korridore/holle	2	200
Mjedise sportive	1	40

Mjedise shërbimi për të tretë		
Mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore	1	6
Mjedise shlodhëse si kafeteri/ fast-food/etj		843
Nyje hidrosanitare për studentët	9	50
Etj....		
Norma m²/për student	7m2/student	

Mjediset për stafin:	**Sasia**	**Sipërfaqja**
Zyra për Dekanin/zv dekanin/ kancelarin	5	64
Zyra për sekretarinë mësimore	2	12
Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore	3	40
Zyra për personelin akademik		758
Zyrë për financën	2	12
Zyrë për Njësinë e SBC	2	12
Salla për mbledhje	2	30
Mjedis për stafin e shërbimit	3	30.25
Nyje hidrosanitare për personelin akademik	8	42
Norma m²/për person	15m2/person	

- Dokumentacioni përkatës

  Dokumentacioni teknik i plkanimetrisë së SHLUJ UMB

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret		**Vlerësimi për Kriteret dhe standardet**
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.		
Kriteri 1	Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;	SHLUJ UMB ka dy kampuse me vendndodhje të përhershme me të gjitha mjediset e nevojshme mësimore, kërkimore administrative dhe të shërbimit.
Kriteri 2	Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;	Mjediset janë pronësi e pronarëve të SHLUJ UMB.
Kriteri 3	Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe	Mësimdhënia dhe aktivitetet e tjera të programit zhvillohen në dy godinat në dispozicion të SHLUJ UMB. Në kampusin 1 ndodhen zyrat e Fakultetit të Ekonomisë dhe Financës dhe biblioteka, ndërsa në kampusin 2 ndodhen sallat e mësimit, laboratori i
Kriteri 4	zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizmin e programeve të studimeve që ofron;	kompjuterave, sekretaria mësimore dhe shërbime ndihmëse. Kjo nuk krijon asnjë problem për koordinimin dhe menaxhimin e veprimtarisë.
	Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.	Kriteri 4 nuk aplikohet për këtë program
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.		

Kriteri 1 **Kriteri 2** **Kriteri 3** **Kriteri 4** **Kriteri 5**	Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore; Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës; Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës; Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim; Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.	SHLUJ UMB ka siguruar një pjesë të teksteve mësimore dhe literaturës ndihmëse për programin që vlerësohet. SHLUJ UMB ka një politikë për përkthimin dhe botimin e teksteve univertsitare. Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme në trajtën e teksteve për Programin "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit". Biblioteka ka botime periodike, libra për fushën e financës. Por është e nevojshme të shtohet kjo literaturë dhe të sigurohet edhe literaturë periodike veçanërisht elektronike. Departamentin Sociologji, Psikologji, Edukim ka paraqitur një plan të detajuar për shtimin e titujve dhe të revistave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët Institucioni ka një planifikim të mirë të aktiviteteve mbështetëse në shërbim të procest mësimor; oraret janë të shpallura në hyrje të bibliotekës dhe në internet.
Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.		
Kriteri 1 **Kriteri 2** **Kriteri 3** **Kriteri 4**	Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve; Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit; Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm; Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.	SHLUJ UMB, për realizimin e programit të studimeve, ka numër të mjaftueshëm sallash me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit. Ka dy laboratorë me PC për studentët si dhe pajisjet e nevojshme për stafin akademik dhe stafin ndihmës. Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit. Laboratorët e informatikës kanë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programit të studimeve.
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u> **Institucioni ka vënë në dispozicion të programit "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" mjedise të mjaftueshme mësimore dhe teknologji mësimore moderne dhe funksionale. Standardet e infrastrukturës plotësohen tërësisht.**		

- **Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare**

  <u>Pjesa përshkrimore</u>

SHLUJ UMB është shoqëri tregtare. Si e tillë ajo arkëton të ardhura kundrejt shërbimeve të ofruara. Ndaj të ardhurat e saj janë ato të siguruara nga tarifat e studimit, që paguajnë studentët. Në institucion funksionojnë disa zyra/individë të ngarkuar për përmbushjen e detyrave financiare: Kancelari i Universitetit, Administratori i Deleguar, Pergjegjësi i Financës, financierët. Në vitin e fundit akademik kostoja për student ka rezultuar 1160 Euro. Shoqëria i nënshtrohet auditimit çdo vit nga ekspertë financiar, si dhe sipas interesit të aksionerëve kryhen dhe kontrolle e auditime të tjera me ekspertë të shoqërive të grupit Dudaj. Gjithashtu i është nënshtruar dhe kontrollit nga organet tatimore. Të dhënat në vijim janë marrë nga bilancet e shoqërisë, të cilat pasqyrojnë të dhëna fiskale sipas viteve kalendarikë.

Tregues të matshëm:

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në dy vitet e fundit (plotëso tabelën 8)

Të ardhurat nga:	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014
Pushteti qendror					
Pushteti vendor					
Fonde jopublike:					
Grantet për kërkim dhe kontratat					
Konsulencat, shërbimet				7.953.294	8.747.857
Tarifat për dhe gjatë shkollimit	66,153,921	81,103,300	107,562,540	99.385.000	93.182.000
Sponsorizimet					
Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)					454.475
Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj					
Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)					
Të tjera (qera, ndryshime kursi valutor, interesa bankare)			170,220	193.789	14.222
Gjithsej	66,153,921	81,103,300	107,562,760	107.532.083	102.398.554
SHUMA					

Shpenzimet për vitin akademik 2012-2014	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014
Paga e sigurime	54,286,979	68.548.102	64.685.240
Shpenzime operacionale	8,200,000	9.209.443	11.657.016
Shpenzime kërkimi e zhvillimi	5,455,585	3.169.363	1.451.651
Shpenzime studentore	3,110,000	3.551.307	570.360
Shpenzime marketingu	8,516,367	3.566.121	8.560.028
Shpenzime infrastrukture e amortizime	6,670,535	6.636.222	5.269.622
SHUMA	86,239,463	94.678.058	92.193.017

- Dokumentacioni përkatës

Raporte të auditit
Bilance financiare vjetore

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret		Vlerësimi për Kriteret dhe standardet
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.		
Kriteri 1 **Kriteri 2** **Kriteri 3**	Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë; Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë; Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.	Raporti i auditit të brendshëm përmban një pasqyrë të qartë të situatës financiare për përdorimin e të ardhura të grumbulluara nga shërbimet që ofron institucioni në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë. Raporti i auditit të brendshëm përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara në funksion të realizimit të programeve të studimeve dhe të eficienës së përdorimit të buxhetit dhe të kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë. Raporti i auditit të brendshëm analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.		
Kriteri 1 **Kriteri 2**	Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.; Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.	Zyra e Financës e SHLUJ UMB harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve master. Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen. Fakti që SHLUJ UMB është pjesë e Shoqërisë "Dudaj" e garanton qëndrueshmërinë dhe përparimin.
Konkluzionet e vlerësimit: **SHLUJ UMB ka hartuar një politikë financiare dhe ka zbatuar procedura që respektojnë kriteret dhe standardet për burimet dhe vlerësimin financiar. Institucioni disponon raporte financiare dhe tregues për qëndrueshmëri financiare.** **Në SHLUJ UMB, përgjegjësinë për menaxhimin financiar e ka Zyra e Administratorit të Deleguar dhe Zyra e Financës. Kancelari është autoriteti që përgatit raportin e auditit të brendshëm për gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë. Burimet kryesore të të ardhurave janë kapitali financiar i Shoqërisë „Dudaj" pjesë e të cilës është SHLUJ UMB, të ardhurat e siguruara nga tarifa e shkollimit që paguajnë studentët dhe grantet e projekteve. Pjesa më e madhe e burimeve financiare janë përdorur për burimet njerëzore, pra për**		

personelin e brendshëm dhe të jashtëm duke i vënë një rëndësi të madhe nivelit të mësimdhënies dhe kërkimit në këtë institucion. Zëri i dytë i rëndësishëm në buxhet janë investimet për infrastrukturën. Eshtë shtuar Kampusi 2, është siguruar një teknologji mësimore bashkëkohore, është investuar për qendrën e testimit sipas marrëveshjes me Pearson Testing Center, është pasuruar biblioteka. Investimet në infrastrukturë kanë krijuar kushte të nivelit bashkëkohor për procesin e mësimit dhe të kërkimit. Zëri i tretë i rëndësishëm për nga rëndësia në shpenzime është parashikuar për veprimtaritë kërkimore dhe sociale.

Standardet e aspektit financiar janë plotësuar.

- ## Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

SHLUJ UMB ka përgjegjësinë përpara shoqërisë shqiptare që të ofrojë një cilësi të lartë të mësimit, të kërkimit dhe të shërbimeve; të demonstrojë se po bën përpjekjet e mundshme më të mira për të përdorur me efektshmëri burimet dhe të garantojë se standardet shtetërore të cilësisë janë përmbushur. Sigurimi i cilësisë shtrohet me theks të veçantë edhe për një sërë arsyesh të tjera, si: zhvillimi i SHLUJ UMB, kërkesat e reja të shoqërisë shqiptare, konkurrenca, evropianizimi, internacionalizimi i arsimit të lartë dhe objektivat e Procesit të Bolonjës.

Për të garantuar cilësinë, efektshmërinë e kërkuar dhe përmbushjen e standardeve, SHLUJ UMB ka miratuar dokumentin e Politikës së Vlerësimit dhe ka ngritur organizmat e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Dokumenti i Politikës së Vlerësimit përmban kriteret e sigurimit të cilësisë, funksionet e organizmave të sigurimit të cilësisë dhe procedurat e vlerësimit të brendshëm.

Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të cilësisë dhe akreditimit. Vlerësimi i jashtëm i cilësisë kryhet nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë. Akreditimi kryhet nga organizma të përcaktuara sipas ligjit.

Vlerësimi i brendshëm është procesi që kryhet nga institucioni, programi i studimit për të gjykuar për përmbushjen e standardeve të cilësisë, është një reflektim kolektiv institucional dhe një mundësi për të përmirësuar cilësinë. Procesi i vlerësimit të brendshëm përfshin mbledhjen sistematike të të dhënave administrative, anketimin e studentëve dhe të diplomuarve, intervistimin e pedagogëve dhe të studentëve. Ky proces përmbyllet me një raport që analizon statusin e institucionit ose/dhe të programit të studimit përkundrejt standardeve shtetërore të cilësisë.

Për sigurimin e brendshëm të cilësisë në SHLUJ UMB vepron Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e përbërë nga dy seksione:

- Seksioni që përgjigjet për cilësinë e programeve bachelor
- Seksioni që përgjigjet për cilësinë e programeve master

NJSBC ka autonomi vepruese dhe akses për të gjitha të dhënat në SHLUJ UMB. Roli i NJSBC është të krijojë një kulturë që synon të arrijë dhe ruajë një cilësi të lartë të veprimtarisë akademike dhe kërkimore në SHLUJ UMB.

Funksione të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë:

Në fushën e sigurimit të cilësisë

- Të zbatojë politikën e vlerësimit të cilësisë në SHLUJ UMB;
- Të hartojë planin kalendar të realizimit të veprimtarive të vlerësimit të brendshëm në nivel institucioni;
- Të monitorojë cilësinë brenda SHLUJ UMB;
- Të organizojë procesin e vlerësimit të brendshëm;
- T'u ofrojë njësive bazë të SHLUJ UMB shërbime këshillimi për vlerësimin e brendshëm dhe përmirësimin e cilësisë;
- Të udhëzojë njësitë bazë të SHLUJ UMB për përgatitjen e raporteve të vlerësimit për programet që mbulojnë dhe veprimtarinë e njësive përkatëse;

- T'i asistojë grupit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në përgatitjen e raportit të vlerësimit të brendshëm;
- Të ruajë të dhënat e vlerësimit të brendshëm;
- Të publikojë raportet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm;
- Të organizojë programe trajnimi për sigurimin e cilësisë brenda SHLUJ UMB;
- Të përgatisë Manualin e Sigurimit të Cilësisë;
- Të bashkëpunojë me Komisionin e Sigurimit të Cilësisë për veprimtarinë e sigurimit të cilësisë.
- Të marrë pjesë në programet e trajnimit dhe në takimet që lidhen me cilësinë në arsimin e lartë në Shqipëri.

Në fushën e akreditimit

- Të përgatisë dhe të ndjekë procesin e akreditimit institucional dhe të programeve;
- Të ruajë të dhënat e procesit të akreditimit;
- Të bashkëpunojë me APAAL për procesin e akreditimit;
- Të publikojë vendimet e akreditimit.

Në fushën e kërkimit dhe të zhvillimit

- Të nxisë veprimtaritë për përmirësimin e cilësisë në SHLUJ UMB;
- Të lehtësojë zbatimin e rekomandimeve të raporteve të vlerësimit për institucionin, programet dhe të monitorojë ecurinë e zbatimit të tyre;
- Të jetë një pikë qëndrore për planifikimin institucional, përfshirë edhe përmirësimin e programeve aktuale dhe zhvillimin e programeve të reja;
- Të rivlerësojë programet e monitorimit dhe të vlerësimit të brendshëm;
- Të kryejë analiza mbi bazën e të dhënave të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtë;
- Të publikojë buletine të vlerësimit;
- Të bashkëpunojë me NJSBC të institucioneve të tjera të arsimit të lartë për të shkëmbyer përvojën dhe për të rritur cilësinë e arsimit të lartë në Shqipëri.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përgatit çdo vit vlerësime të cilësisë të cilat janë diskutuar dhe në mbëdhje të veçanta në Senat.

Këshilli i Sigurimit të Cilësisë është një organizëm që ngrihet dhe funksionon në nivel institucioni i cili ka përgjegjësinë për të garantuar se SHLUJ UMB i plotëson standardet e cilësisë. Ky organizëm përgjigjet për politikën së vlerësimit dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të brendshëm të cilësisë. KSC i raporton drejtpërdrejt Senatit të SHLUJ UMB.

SHLUJ UMB është një instiucion i Akredituar, gjithashtu i është nënshtruar proceseve të vlërësimit të jashtëm dhe akreditimin të disa programeve në nivel bachelor dhe master.

Tregues të matshëm:

- Të dhëna për anëtarët e NJBSC (plotëso tabelën 9)

Tabela 9

	Anëtarët e NJBSC	Detyra që ka në në NJBSC	Sa kohë ka në këtë detyrë
1	Robert Gjedia, Dr.	Përgjegjës i cilësisë së studimeve master	2014
2	Migena Kapllanaj, Doktorante	Specialiste, Studimet master	2010
3	Gëzim Hadaj, Prof. Dr.	Pedagog i shkencave të edukimit	2010

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë kryen anketime çdo semestër, dy javë përpara mbarimit të tij. Pra, me secilin grup, çdo vit, dy herë. Përgjithësisht tendenca ka qenë për të marrë mendime për çdo lëndë të programit. Numri i studentëve të anketuar ndryshon nga njëri anketim në tjetrin, në varësi dhe të studentëve të pranishëm në momentin e kryerjes.

Të gjithë pyetsorët përpunohen dhe rezultatet i paraqiten me shkrim Rektorit. Rezultatet e tyre bëhen pjesë e diskutimeve në Senat. Gjithashtu rezultatet u komunikohen pedagogëve individualisht. Studentët njoftohen për rezultatet e vlerësimeve të tyre për çështje të përmirësimit të kurrikulave dhe të mësimdhënies.

Bazuar në këto vlerësime janë bërë ndryshime në kurrikula, përmirësime të niveleve të shërbimit, mbyllje kontratash me staf akademik, etj. Forma të tjera të vlerësimit të programit janë mendimet e gjeneruara nga pedagogët, veçanërisht stafi i jashtëm, nga Zyra e rekrutimit, këshillimit.

NJSBC disponon raportet e vlerësimit, formularët e vlerësimit dhe të dhëna statistikore për vlerësimin e brendshëm.

- Dokumentacioni përkatës

- Dokumenti i Politikës së Vlerësmit
- Formular i vlerësimit të studentëve për pedagogun dhe lëndën
- Formular i vlerësimit të aktivitetit akademik që plotësohet nga secili pedagog

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret		Vlerësimi për Kriteret dhe standardet
Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.		
Kriteri 1 **Kriteri 2**	Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë; Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.	Në bazë të politikës së vlerësimit të SHLUJ UMB, Departamentin Sociologji, Psikologji, Edukim harton një raport analize vjetore për ecurinë e programit. SHLUJ UMB ka dokumentin e politikës së vlerësimit në të cilin janë parashikuar politikat dhe procedurat që ndihmojnë për përmirësimin e programeve të studimit. Departamentin Sociologji, Psikologji, Edukim në bashkëpunim me NJSBC kanë realizuar monitorimin, vlerësimin e studentëve për lëndët mësimore dhe analizën vjetore për ecurinë e programit.
Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.		
Kriteri 1 **Kriteri 2** **Kriteri 3** **Kriteri 4** **Kriteri 5** **Kriteri 6**	Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akreditaur në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve; Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë; Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre; Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit; Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to; Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.	SHLUJ UMB është akreditaur në nivel institucioni me Urdhërin Nr.288 datë 04.09.2009 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. SHLUJ UMB ka një paketë me instrumente për sigurimin e cilësisë që përbëhet nga formularë, pyetësorë dhe raporte për njësitë kryesore, bazë, për pedagogët, studentët, punëdhënësit. SHLUJ UMB ka përgatitur dokumentin e politikës së vlerësimit dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre. SHLUJ UMB kryen shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit. SHLUJ UMB ka përgatitur materiale dhe ka organizuar trajnime për informimin dhe ndërgjegjësimin e personelit dhe të studentëve për sigurimin e cilësisë

		dhe rolin e tyre në këtë proces. SHLUJ UMB ka hartuar dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë bërë publike në takime me pedagogë dhe studentë dhe janë publikuar në faqen e Internetit të SHLUJ UMB. SHLUJ UMB ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Me hapjen e studimeve të ciklit të dytë, NJSBC u riorganizua në dy seksione: seksioni që përgjigjet për cilësinë e programeve bachelor dhe seksioni që përgjigjet për cilësinë e programeve master. NJSBC ka autonomi vepruese dhe akses për të gjitha të dhënat në SHLUJ UMB. Eshtë hartuar dokumenti i politikës së vlerësimit që përshkruan kriteret e sigurimit të cilësisë, procedurat e vlerësimit të brendshëm dhe funksionet e organizmave të sigurimit të cilësisë: të njësisë, seksioneve dhe të komitetit të cilësisë. Roli i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është të krijojë një kulturë që synon të arrijë dhe ruajë një cilësi të lartë të veprimtarisë akademike dhe kërkimore në SHLUJ UMB. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë kryen funksionet e monitorimit, të vlerësimit, të trajnimit, të kërkimit, të informimit. Ajo kryen veprimtarinë sipas fushave të paraqitur më poshtë. *Në fushën e sigurimit të cilësisë* • Të bashkëpunojë me fakultetet dhe njësitë e tjera të SHLUJ UMB për veprimtarinë e sigurimit të cilësisë; • Të përgatisë Manualin e Sigurimit të Cilësisë; • Të ofrojë shërbime koordinimi për vlerësimin e brendshëm dhe përmirësimin e cilësisë; • Të monitorojë cilësinë brenda SHLUJ UMB; • Të organizojë procesin e vlerësimit të brendshëm; • Të udhëzojë fakultetet, institutet dhe departamentet në përgatitjen e raporteve të vlerësimit për programet që mbulojnë dhe veprimtarinë e njësive përkatëse; • Të përgatisë raportin e vlerësimit të brendshëm; • Të ruajë të dhënat e vlerësimit të brendshëm; • Të publikojë raportet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm; • Të organizojë programe trajnimi për sigurimin e cilësisë brenda SHLUJ UMB; • Të marrë pjesë në programet e trajnimit dhe në takimet që lidhen me cilësinë në arsimin e lartë në Shqipëri. ***Në fushën e akreditimit*** • Të përgatisë udhëzues për procedurat e akreditimit; • Të ndjekë procesin e akreditimit; • Të ruajë të dhënat e procesit të akreditimit; • Të bashkëpunojë me APAAL;

		• Të publikojë vendimet e akreditimit. ***Në fushën e kërkimit dhe të zhvillimit*** • Të nxisë veprimtaritë për përmirësimin e cilësisë në SHLUJ UMB; • Të lehtësojë zbatimin e rekomandimeve të vlerëesimit dhe të rekomandimit për institucionin, programet, lëndët mësimore, dhe të monitorojë ecurinë e zbatimit të tyre; • Të bashkëpunojë me NJSBC të institucioneve të tjera të arsimit të lartë për të shkëmbyer përvojën dhe për të rritur cilësinë e arsimit të lartë në Shqipëri; • Të jetë një pikë qëndrore për planifikimin institucional, përfshirë edhe zhvillimin e programeve të reja; • Të rivlerësojë programet e monitorimit. SHLUJ UMB ka ndërmarrë një sërë hapash për ta bërë sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë të qëndrueshëm. • Është përgatitur dhe miratuar dokumenti i politikës së vlerësimit të brendshëm. • Është ngritur NJSBC si një njësi e përhershme në strukturën e SHLUJ UMB. • Është emëruar stafi i NJSBC. • Është ngritur Komiteti i Sigurimit të Cilësisë. • SHPUL UMB ka përvojë në procesin e vlerësimit të brendshëm dhe të akreditimit të institucionit dhe të programeve Bachelor dhe Master Profesional • Bashkëpunon me ekspertë të jashtëm të fushës së vlerësimit, gjë që i siguron ekspertizën e duhur. SHLUJ UMB ka mekanizma formalë për vlerësimin e programeve të studimit si për, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit. SHLUJ UMB synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to. Kjo pasqyrohet në Dokumentin e Politikës së Vlerësimit. SHLUJ ka Dokumentin e Politikës së Vlerësimit i cili parashikon procedurat për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.		

Kriteri 1 **Kriteri 2** **Kriteri 3** **Kriteri 4**	Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve; Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë; Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë; Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta. <u>Të tërthorta:</u> • Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; • Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; • Pyetje konceptuale; • Intervista; • Etj. <u>Të drejtpërdrejta:</u> • Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); • Dëgjime në auditor; • Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; • Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; • Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.); • Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; • Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës; • Etj.	SHLUJ UMB ka një dokument të politikës së vlerësmit dhe një paketë me instrumente për vlerësimin e programit. Përdoret vlerësimi formues dhe përmbledhës. Informacioni për vlerësimin e programit të studimit është përfshirë në raportin e vlerësimit të brendshëm. SHLUJ UMB i ka bërë publike rezultatet e vlerësimit të brendshëm në Senatin e Universitetit, ua ka komunikuar pedagogëve dhe studentëve. SHLUJ UMB ka përcaktuar metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për kryerjen e vlerësimit, të brendshëm, përdor një paketë me instrumente të vlerësimit. Janë përdorur procedurat dhe instrumentet e mëposhtme: • Monitorim i përvitshëm • Raport i përmbledhur vlersërimi në përfundim të çdo viti • Vlerësim nga studentët për çdo lëndë • Feedback nga studentët që ndjekin programet e studimeve dhe nga të diplomuarit në këto programe • Feedback nga pedagogët • Formularë vlerësimi • Pyetësorë • Intervista • Rezultatet e studentëve në provime • Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (detyra kursi, projekte, punë individuale, punë në grup) • Vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës • Rezultate të provës finale.
Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.		
Kriteri 1 **Kriteri 2**	Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm; Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj., për vlerësimin e brendshëm.	SHLUJ UMB ka përgatitur raporte dhe buletine për vlerësimin e brendshëm. SHLUJ UMB ka publikuar informacion në faqen e internetit për vlerësimin e brendshëm.
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u> **SHLUJ UMB ka ngritur dhe ka institucionalizuar sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe e ka bërë vlerësimin pjesë integrale të veprimtarisë së tij. Ngritja e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, hartimi i politikës së vlerësimit, përcaktimi i procedurave, përgatitja e instrumenteve, menaxhimi i procesit të vlerësimit të brendshëm, trajnimi i personelit dhe i studentëve për të përmbushur rolin e vlerësuesit janë**		

tregues që dëshmojnë për një sistem vlerësimi veprues. Akreditimi institucional dhe i programeve Bachelor në vitin 2009 dhe i programeve Master Profesional në vitin 2012 është një tregues i njohjes zyrtare të cilësisë së SHLUJ UMB.
Standardet që lidhen me sigurimin e cilësisë janë përmbushur tërësisht.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

- **Programi i studimit, organizimi i tij**

Pjesa përshkrimore

Kriteret dhe procedurat e pranimit janë përcaktuar në Rregulloren e studimeve dhe përfshijnë:

- Diplomë Bachelor. Të zotërojë një diplomë universitare "Bachelor" ose diplomë tjetër studimi të fituar brenda apo jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me të në fushën përkatëse ose në fusha të përafërta me programin për të cilin aplikon. Në rastin kur diploma nuk përputhet me fushën e programit të kërkuar, departamenti që mbulon programin përkatës të studimeve master vlerëson nëse kualifikimet dhe përvoja në fushë janë të mjaftueshme apo përcakton nëse kandidati duhet të realizojë një program përafrimi.
- Të ketë rezultate të mira akademike të sudimeve Bachelor.
- Të ketë përvojë pune mbi 1 vit.
- Të zotërojë dëshmi të gjuhës angleze ose të japë provimin e gjuhës angleze në përfundim të studimeve mbi bazën e një testimi të njohur ndërkombëtar.
- Të arrijë rezultate të mira në çdo testim pranimi ose intervistë të kërkuar nga departamenti që mbulon Programin Master.
- Të shprehë qartë qëllimin e ndjekjes së studimeve në Programin "Master Profesional".
- Të jetë i rekomanduar nga dy persona të cilët i njohin aftësitë akademike, profesionale, kërkimore dhe personale të kandidatit.
- Të përballojë shpenzimet e shkollimit.

Gjithashtu SHLUJ Universiteti Marin Barleti pranon transferime të studentëve në vitet e ndërmjetme nga shkollat e tjera universitare vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të saj në shkolla të tjera sipas disa procedurave dhe një dokumentacioni të kërkuar, kjo sipas rregullore se tranferimeve.

Tregues të matshëm:

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi
- Organizimi i çdo programi studimi (vite, semestra, javë etj.)
  - 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
  - 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
  - 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit
  - 1 orë mësimore = 60'
- Emërtimi i Diplomës për programin e studimit,

  Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim Arsimi

- Plani mësimor sipas modelit të tabelës 10)

Tabela 10

	Viti I (Viti II) Lëndë/Module	Semestri	ECTS	Orë në javë	Orë mësimore														Provime
					Leksione			Seminare			Laborator			Praktikë						
					ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e Pavarur	**Orë në auditor**	**Punë e Pavarur**	**Gjithsej**	
1	Baza të drejtimit dhe administrimit të arsimit	I	**6**			40			20								60	90	**150**	
2	Politika arsimore	I	**6**			40			20								60	90	**150**	
3	Metoda të kërkimit në edukim	I	**6**			40			20								60	90	**150**	
4	Dimensioni ligjor i arsimit	I	**7**			45			30								75	100	**175**	
5	Dimensioni ekonomik i arsimit	II	**7**			45			30								75	100	**175**	
6	Organizimi i shkollës	II	**7**			45			30								75	100	**175**	
7	Praktikë profesionale	I	**5**														75	50	**125**	
8	Prova finale	II	**16**														135	265	**400**	
	Totali		**60**														**615**	**885**	**1500**	

- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit për:
  - Leksionet 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit
  - Seminaret 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit
  - Praktikën Profesionale 75 orë në institucion dhe 50 orë punë e pavarur e studentit
  - Provimi përfundimtar 135 orë në auditor dhe 265 orë punë e pavarur e studentit

- Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-F) (plotëso Tabelën 11)

Tabela 11: **PLANI MËSIMOR MP/Drejtim dhe administrim arsimi**			
Tipi i Veprimtarisë (A-F)	Lënda/Moduli	Kreditet	Totali
Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (**A**)	Baza të drejtimit dhe administrimit të arsimit	6	**18**
	Politika arsimore	6	
	Metoda të kërkimit në edukim	6	
Veprimtari në disiplina të formimit karakterizues (**B**)	Dimensioni ligjor i arsimit	7	**21**
	Dimensioni ekonomik i arsimit	7	

	Organizimi i shkollës		7	
Vepr. në disiplina të Ngjashme dhe/ose integruese (**C**)				
Veprimtari në disiplina me zgjedhje (**D**)				
Njohuri të tjera formuese si plotësime në gjuhët e huaja, informatikë, stazh, apo praktika (**E**)	Praktikë profesionale	5		**5**
Teza e Diplomës (**F**)	Prova finale		16	**16**

- Ndryshimet në planin mësimor, krahasuar me programet e licensuara

  Nuk ka ndryshime në planin mësimor krahasuar me programet e licensuara.

- Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës (plotëso Tabelën 12)

Tabela 12[1]

Lënda /Moduli		Pedagogu/Pedagogët përgjegjës	Titulli/grada kualifikimi	Departamenti	Statusi PAE apo PAK
1	Baza të drejtimit dhe administrimit të arsimit	Sotir Rrapo	Prof. Asoc.	Sociologji, Psikologji, Edukim	PAK
2	Politika arsimore	Michael Totterdell	Prof.	Sociologji, Psikologji, Edukim	PAE
3	Ndryshimi në arsim	Lekë Sokoli	Dr.	Sociologji, Psikologji, Edukim	PAE
4	Metoda të kërkimit në edukim	Lekë Sokoli	Dr.	Sociologji, Psikologji, Edukim	PAE
5	Menaxhimi strategjik në arsim	Saemira Pino	Dr.	Sociologji, Psikologji, Edukim	PAE
6	Dimensioni ligjor i arsimit	Juliana Latifi	Prof. Asoc. Dr.	Sociologji, Psikologji, Edukim	PAK
7	Dimensioni ekonomik i arsimit	Servete Gruda	Prof. Asoc. Dr.	Sociologji, Psikologji, Edukim	PAK
8	Organizimi i shkollës	Marjana Çadri	Dr.	Sociologji, Psikologji, Edukim	PAE
9	Vlerësimi në arsim	Marjana Çadri	Dr.	Sociologji, Psikologji, Edukim	PAE

- Syllabus-et për çdo lëndë, ku duhet të pasqyrohen këto elemente

  Të gjitha programet e këndëve të programit Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Adminsitrim Arsimi " përmbajnë elementet e mëposhtme

  - Emërtimi i lëndës/modulit
  - Viti/semestri kur zhvillohet lënda
  - Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
  - Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
  - Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
  - Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
  - Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
  - Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS

[1] Ky staf ka dhënë mësim në këtë cikël studimesh master, sepse ky program është zhvilluar vetëm një here në periudhën 2011-2013

- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

- Dokumentacioni përkatës

Paketa e programeve mësimore të lëndëve

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret		Vlerësimi për Kriteret/ standardet
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.		
Kriteri 1 **Kriteri 2**	Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS); Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	Programi "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" i është nënshkruar procedurës së vlerësimit paraprak në APAAL, është hapur në bazë të Urdhërit Nr. 549 datë 11.11.2011 të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencëc. Programi është i organizuar në module dhe lëndë mësimore, të cilat janë të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Plani mësimor i këtij programi parashikon ngarkesën me 60 kredite për dy vite akademikë.
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.		
Kriteri 2 **Kriteri 3** **Kriteri 4** **Kriteri 5** **Kriteri 6**	Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave", "Master i arteve të bukura" apo "Master Profesional" i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare "Bachelor" me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional; Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukura" dhe "Master Profesional" synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve; Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi; Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit	Programi "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" i pajis studentët me njohuri të thelluara teorike me aftësi praktike, me aftësi për kërkim shkencor dhe i trajnon për profesionin. Kjo dëshmohet në komponentët e planit mësimor dhe në përmbajtjen e programeve të lëndëve mësimore. Programi "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" ngrihet mbi bazën **e** programeve Bachelor në shkenca sociale, por synon një specializim të thelluar në politika dhe drejtim arsimi. Kriteri 4 nuk aplikohet për këtë program Programi "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" i pajis studentët me njohuri të thelluara teorike dhe praktike. Programi synon që studentët në përfundim të studimeve të zotërojnë kompetencat të cilat janë të pasqyruara në Rregulloren e Studimeve. **Kompetenca të përgjithshme** • për të drejtuar dhe menaxhuar; • për të komunikuar me një regjistër të avancuar profesional; • për të analizuar; • për të vlerësuar dhe reflektuar për çështje të drejtimit dhe të administrimit të arsimit;

Kriteri 7	të tij; Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukura"dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve; Programet e studimeve "Master Profesional" kanë objektiva të qartë profesionalë, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	• për të qenë krijues. **Kompetenca specifike** • për të kuptuar problematikën që lidhet me politikën arsimore, me drejtimin dhe administrimin e arsimit, të shkollës; • për të menaxhuar burimet humane, materiale, financiare; • për të zgjidhur problemet; • për të përdorur kërkimin në kontekst arsimor; • për të hartuar dokumente të planifikimit strategjik. **Kompetenca të transferueshme** • të shkruajnë dokumente të politikës arsimoret; • të përdorim burime dhe teknologji informacioni; • të marrin pjesë në debate, diskutime; • të vlerësojnë në mënyrë kritike evidenca; • të zhvillojnë aftësi negociimi; • të zhvillojnë aftësitë e reflektimit. Programi "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" i pajis studentët me njohuri të thelluara teorike dhe aftësi të kërkimit shkencor dhe kompetenca për profesionin. Kjo dëshmohet në planin mësimor i cili parashikon lëndë bazë të formimit teorik, lëndë të formimit të specializuar në fushë, lëndë të kërkimit shkencor, praktikë profesionale dhe punim diplome.
Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.		
Kriteri 1 **Kriteri 2**	Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interest kombëtare; Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.	Programi "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" nuk bie ndesh me interesat kombëtare. Programi i studimeve synon të ndihmojë në ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare. Këtë e realizoin nëpërmjet theksimit të vlerave kombëtare në çdo lëndë mësimore.
Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.		
Kriteri 1 **Kriteri 2**	Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato; Metodat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.	Objektivat e këtij programi përputhen me nivelin e studimeve të ciklit të dytë në të cilin ofrohen. *Në aspektin e njohurive,* programi përmbanë njohuri shumë të specializuara, disa prej të cilave në nivel të avancuar bashkëkohor në fushën e edukimit dhe shërbejnë si bazë për një të menduar të pavarur, kërkim origjinal, analizë kritike. *Në aspektin e aftësive,* programi zhvillon aftësi të specializuara për politikat dhe drejtimin e arsimit, për kërkim shkencor. *Në aspektin e kompetencave*, programi formon dhe zhvillon kompetenca të përgjithshme, speciale dhe të transferueshme të cilat mundësojnë menaxhim dhe transformim të konteksteve të punës, qëndrim të pavarur, performancë të efektshme. Për të përmbushur këtë standard SHLUJ UMB është mbështetur në metodologjinë e përpunuar në kuadrin e Projektit Evropian Tuning dhe në dokumentet e Procesit të Bolonjës, veçanërisht në

		Përshkruesit e Dublinit. Vlerësimi i studentëve realizohet përmes disa formave në përshtatje me specifikat e lëndës, si: vlerësimim i vazhduar (detyrë kursi, studim rasti, projekt, analizë dokumenti, etj.) provim përfundimtar (me gojë ose me shkrim). Skema e vlerësimit është e parashikuar ne Rregulloren e Studimeve dhe në çdo program lënde.
Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.		
Kriteri 1 **Kriteri 2** **Kriteri 3**	Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikat e mira të vendeve europiane; Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e tranferimit të krediteve e njohurive të fituaara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri; Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.	Programi "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" është hartuar duke mbajtur parasysh përvojën e disa universiteteve me të cilat SHLUJ UMB bashkëpunon, si të Universitetit të Bolonjës, të Universitetit Clemson. Programi i ofruar përmban elemente që respektojnë standardet më të mira ndërkombëtare të kurrikulës universitare, të përcaktimit të krediteve, të kritereve të pranimit dhe përpiqet t'i integrojë me vlerat më të mira të arsimit universitar në Shqipëri. Programi i studimit përmbush kriterin për të qenë të konkurrueshëm ndërkombëtarisht për nga elementet e përmbajtjes pasi ai përfshin rubrikat, si: të dhëna të përgjithshme, misionin, objektivat, rezultatet e të nxënit, planin mësimor, organizimin mbi bazën e krediteve, përcaktimin e kritereve të pranimit, metodologjinë e mësimdhënies dhe të vlerësimit, përcaktimin e kritereve dhe procedurave të transferimit të krediteve. Programi i ofruar është ndërtuar në frymën e përgjithshme të legjislacionit dhe direktivave të BE për arsimin e lartë. Vlen të vihet në dukje se programi është bazuar në përvojën e Projektit evropian TUNING.
Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.		
Kriteri 1 **Kriteri 2** **Kriteri 3** **Kriteri 4**	Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor; Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim; Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizmin e programeve të studimeve; Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.	Programi "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" synon pajisjen e studentëve me aftësi profesionale dhe të kërkimit në fushën e politikave dhe drejtimit të arsimit. Aftësimi praktik realizohet si nëpërmjet komponentit të praktikës ashtu edhe trajtimit profesional të rasteve konkrete. Ndërsa aftësimi për kërkimin shkencor realizohet si nëpërmjet lëndës të posaçme të metodave të kërkimit, të elementeve të kërkimit të të gjitha lëndëve dhe të provës finale që kërkohet në trajtën e një kërkimi shkencor. Programi "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" përputhet plotësisht me profilin e SHLUJ UMB dhe me strategjinë e zhvillimit të këtij institucioni. Dokumentacioni i Programit "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit", dosjet personale të pedagogëve dhe lista e të dhënave për kërkimin shkencor dëshmojnë se pedagogët e këtij programi janë të angazhuar në veprimtarinë kërkimore shkencore dhe veprimtaria e tyre e spikatur në fushën e kërkimit integrohet me mësimdhënien dhe ndihmon në realizmin e synimeve të programit të studimeve. Veprimtaria e personelit akademik të Programit

		"Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" me kohë të plotë përputhet me synimet që ka përcaktuar programi. Shih listën e të dhënave për kërkimin shkencor që disponon Zyra e Masterave.
Standardi I.7 - Programet e studimeve "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.		
Kriteri 1 **Kriteri 2**	Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës; Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.	Programi "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" përputhet me kërkesën e tregut për specialistë të politikave arsimore dhe drejtues të efektshëm të arsimit. Programi jep mundësi që të diplomuarit të punojnë në sektorin e arsimit vendas dhe në rajon, veçanërisht në shkollat ku mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe.
Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.		
Kriteri 1 **Kriteri 2**	Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar; Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin: • mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; • kërkesat e punëdhënësve; • një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; • numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.	Programi i studimit përputhet me synimin e strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrimin, mban parasyshh nevojat e tregut të punës dhe bazohet në modelet më të përparuara bashkëkohore evropiane. Kjo pasqyrohet në misionin e programit, në programet lëndore dhe në veprimtarinë që kryen departamenti përkatës. SHLUJ UMB ka kryer investigime të tregut dhe anketime për kërkesat e tregut vendas dhe rajonal për specialistë të politikës arsimore, ka siguruar të dhëna për IAL që ofrojnë programe në drejtim dhe administrim arsimi. Informacioni i mbledhur ka mundësuar parashikimin e numrit të studentëve të mundshëm për të ndjekur programin.
Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.		
Kriteri 1	Programet e studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program.
Kriteri 2	Programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.	Programi "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" që është objekt i këtij vlerësimi realizohet me 60 kredite (ECTS). Plani mësimor i këtij programi ka 39 kredite per pjesën teorike nga të cilat 12 kredite për formimi bazë, 21 kredite për formimin e specializuar, 6 kredite për formimin kërkimor, 16 kredite për provën finale dhe 5 kredite për praktikën. Kohëzgjatja normale e këtij programi është 1 vit akademik.
Kriteri 3	Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program.

	diplomës "Master i Shkencave". Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).	
Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.		
Kriteri 1 **Kriteri 2**	Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar; Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program.
Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.		
Kriteri 1 **Kriteri 2**	Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët; Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.	Që në ditën e fillimit të studimeve, studentëve u jepet rregullorja e studimeve, plani mësimor, programet e lëndëve, orari i mësimit, ndërsa paketa e praktikës dhe e provës finale jepen në periudhën para fillimit të tyre. Gjithashtu studentët mund të informohen nëpërmjet broshurave, fletëpalosjeve dhe faqes së internetit të SHLUJ UMB. Informacioni për programet e studimit i ofrohet studentëve në formë të shkruar dhe elektronike dhe është i publikuar në faqen zyrtare të internetit të SHLUJ UMB.
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u> **Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Zyra e masterave kanë administruar shumë mirë programin e studimit** "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit"**. Programi Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" është ndërtuar që t'i shërbejë ruajtjes së vlerave kulturore dhe interesave kombëtare, të tilla si demokracia, diversiteti, shpirti i sipërmarrjes, toleranca, bashkëpunimi, drejtësia, respektimi i të drejtave të njeriut, zhvillimi i qëndrueshëm, integrimi evropian. Programi i trajton, mbështet dhe i kultivon këto vlera nëpërmjet përmbajtjes mësimore, kërkimit dhe veprimtarive. Programi i studimit dhe programet e lëndëve kanë informacionin e kërkuar sipas standardeve. Departamenti përgjegjës ka bërë një shpërndarje korrekte të ngrakesës mësimore në kredite duke respektuar standardet e kërkuara.** **SHLUB UMB ofron një informacion të shumëllojshëm lidhur me programet e studimit MP për kriteret e pranimit, për procedurën e aplikimit, për planin mësimor, programet lëndore, për praktikën, për provën finale, për vlerësimin, për politikën e zhvillimit strategjik, për veprimtaritë kërkimore, sociale dhe kulturore, për rregulloren e studimeve. Informacioni ofrohet nëpërmjet zyrave të informacionit, nëpërmjet fletëpalosjeve, broshurave, faqes së internetit.** **Standardet e këtij aspekti janë përmbushur plotësisht.**		

- **Mësimdhënia**

<u>Pjesa përshkrimore</u>

Mësimdhënia organizohet duke kombinuar disa forma. Forma bazë është ajo e kombinimit të leksioneve, seminareve, prezantimeve të detyrave të studentëve, prezantimi i videove të ndryshme në varësi të temave dhe diskutimi në lidhje me to, prezantimi i rasteve të ndryshme, analiza e rasteve hipotetike apo simulative të ofruara nëpërmjet videove. Po kështu organizimi i lektoriumeve me figura të njohura të fushës. Sa i takon vlerësimit përgjithësisht përqindjet variojnë sipas lëndëve dhe kritereve që përdoren.. Gjithashtu studentët bëhen pjesë dhe e projekteve të Fakultetit apo qendrave kërkimore të UMB.

Tregues të matshëm:

- Ngarkesa totale në auditor për Format e mësimdhënies, (plotëso Tabelën 13)

Tabela 13

Programi i Studimit MP në EDU_DAA		
Format e mësimdhënies		Orët totale në auditor
a.	Leksione	255
b.	Seminare	150
c.	Ushtrime	
d.	Laboratore	
e.	Praktikë lëndore	
f.	Praktikë profesionale (në institucion)	75
g.	Prova finale	135
	Në total	615

- Format e kontrollit të njohurive (plotëso Tabelën 14)

Tabela 14

Format e kontrollit të njohurive	**Pjesa (në %) ndaj totalit**
Ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive	**10%**
Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit)	30
Testimet gjatë vitit	20
Provimi përfundimtar	40
Etj	
Në total	**100%**

- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.(Plotëso Tabelën 15)

Tabela 15

Aktiviteti shkencor i IAL	**Numri i studentëve të aktivizuar**
Për punime shkencore individuale të pedagogëve	
Për projekte shkencore në rang Departamenti	5
Për projekte shkencore në rang Fakulteti	18
Për projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë	8

- **Studentët**

Pjesa përshkrimore

Çështjet që lidhen me politikën e pranimit të studentëve, me kriteret dhe procedurat e pranimit, me statusin e studentëve, të drejtat dhe përgjegjësitë e studentëve, përgjegjësitë e SHLUJ UMB për studentët janë të rregulluara në Rregulloren e studimeve për Programin "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim Arsimi", kreu V dhe VI.

Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve
- Kushte specifike të pranimit të studentëve
- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (plotëso Tabelën 16)

Tabela 16

Programi i studimit MP në EDU-DAA	Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë)	Nota Mesatare	Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse)	Nota Mesatare
Drejtim dhe Administrim Arsimi	14	7,2	11	9,4
Në total	14		11	

- Të dhëna për punësimin e studentëve (plotëso tabelën 17)

Tabela 17

Periudha e të dhënave (2011-2015)			
Programi i studimit MP në EDU-DAA	Numri total të diplomuarve	Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)	Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)
	11	11	11

Meqë ende programi është në proces nuk ka të dhëna për diplomimin.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi për Kriteret dhe standardet
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	

Kriteri 1 **Kriteri 2** **Kriteri 3** **Kriteri 4** **Kriteri 5**	Studentët që ndjekin programet e studimeve "Master i Shkencave" apo "Master Profesional" zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS; Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi; Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni; Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve "Master Profesional" niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve "Master i Shkencave" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Europian të Gjuhëve; Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kritereve të pranimit.	Studentët e Programit "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" pranohen mbi bazën e studimeve Bachelor. Rregullorja e studimit të këtij programi përmban kriteret e pranimit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Studentët e Programit "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. SHLUJ UMB ofron kurse gjuhe dhe në bashkëpunim me PEARSON Testing Center ofron mbrojtjen e gjuhës angleze me test ndërkombëtar. SHLUJ UMB ka respektuar Udhëzimin e MAS për nivelin e gjuhës angleze. SHLUJ UMB ka vlerësuar politikat e pranimit dhe i ka ndryshuar ato në përputhje me ndryshimet që i janë bërë legjislacionit të arsimit të lartë, kërkesave të tregut të punës dhe standardeve të cilësisë së institucionit.
Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.		
Kriteri 1 **Kriteri 2** **Kriteri 3**	Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve; Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion; Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.	SHLUJ UMB ka dy zyra që japin informacion për mundësitë e punësimit dhe ofrojnë shërbimin e këshillimit. Zyra e Alumnit dhe e Karrierës siguron një pikë fokusimi për studentët, komunitetin e gjerë universitar dhe botën e punës. Ajo mbështet në mënyrë aktive të diplomuarit në planet e tyre për karrierën dhe përshtatjen me tregun e punës. Mes studentëve që ndjekin karriera me profil të lartë, ka prej tyre që pas diplomimit nga SHLUJ UMB sot punojnë në dikastere ministrore, japin leksione në universitetet shqiptare, ndërsa të tjerë po kryejnë praktika me vlerë në institucione të rëndësishme të vendit dhe ato evropiane. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Njësia e Programeve Master i informon studentët për akreditimin e institucionit, të programeve të studimit, për procedurat e njohjes dhe vlefshmërisë së diplomave brenda dhe jashtë vendit. Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Zyra e Karrierës u ofron studentëve këshillime për lidhur më punësimin e ardhshëm .
Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.		

Kriteri 1 **Kriteri 2** **Kriteri 3**	Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar; Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik; Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.	SHLUJ UMB ka statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar. Në Programin "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" për vitin akademik 2011-2012 janë regjistruar 14 të cilët janë në proces studimi. SHLUJ UMB ka të statistika vjetore të plota. Për Programi "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" disponohen këto të dhëna Mesatarja në hyrje 7.2 Mesatarja në dalje 9.4 Llarguar 0 Diplomuar 11 Te padiplomuar 3 Gjithsej 14 SHLUJ UMB ka të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim. Këto të dhëna ruhen në regjistrin e arritjeve akademike. Njëkohësisht disponohen edhe të dhëna për performacën e studentëve dhe për mesataret e ponderuara në përfundim të studimeve, e dhënë kjo që shënohet në pasqyrën e rezultateve të studentit që diplomohet. Të dhënat i disponon Sekretaria Mësimore e Masterave dhe Njësia e Masterave.
Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.		
Kriteri 1 **Kriteri 2**	Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre; Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.	SHLUJ UMB ka një bazë të dhënash për punësimin e studentëve pas diplomimit të tyre. Aktualisht SHLUJ UMB bashkëpunon me Clemson University për doktoratën që ky universitet ofron në Shqipëri dhe në kuadrin e përgjegjësive administrative ka një bazë të dhënash për studentët që ndjekin studimet doktorale.
Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.		
Kriteri 1 **Kriteri 2** **Kriteri 3**	Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit; Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit; Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.	Sekretaria mësimore dhe personeli akademik informon në mënyrë të vazhdueshme studentët për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit. Studentët informohen për rezultatet e vlerësimi gjatë programit dhe në përfundim të programit.. Informimi bëhet nga pedagogët dhe Sekretaria mësimore. Pedagogët u japin vazhdimisht studentëve feedback për rezulatet akademike dhe u komunikojnë vlerësimet.
Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.		
Kriteri 1	Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe	SHLUJ UMB i ndihmon studentët për çështje të procesit mësimor nëpërmjet këshillimit që ofron Zyra e Karrierës, secili departament, secili pedagog.

Kriteri 2	problematikave që lidhen me procesin mësimor; Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.	Zyra e Karrierës dhe koordinatori i programit u japin ndihmë studentëve në përzgjedhjen e institucioneve apo kompanive për zhvillimin e praktikës profesionale.

Konkluzionet e vlerësimit:

SHLUJ UMB ndjek një politikë që respekton të drejtat e studentëve, u asiston atyre për çështje mësimore, të karrierës, të praktikës profesionale. Regjistrimi, menaxhimi dhe ruajtja e të dhënave të studentëve kryhen elektronikisht dhe me shkrim dore. Veprimtaria e një sërë zyrave si Zyra e Karrirës dhe Alumnit, Zyra e masterave, Sekretaria Mësimore e bashkërendojnë punën për të ofruar shërbimet që lidhen me studentët. SHLUJ UMB ka politika dhe kritere të qarta për pranimin e studentëve të cilat janë të pasqyruara në Rregulloret e studimeve të programit që po vlerësohet. SHLUJ UMB ka shqyrtuar herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe ka bërë ndryshimet përkatëse. SHLUJ UMB nëpërmjet Zyrës së Karrirës dhe Alumnit si dhe Njësisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë i informon studentët për politkat e punësimit dhe akreditimin e institucionit dhe të programeve. Këshillimi bëhet nëpërmjet seancave, ndërsa informimi bëhet nëpërmjet publikimit të dokumenteve dhe rezultateve të akreditimit. SHLUJ UMB informon studentët në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit. Për këtë qëllim shërbejnë Rregullorja e Studimeve MSH, broshurat, faqja e internetit, takimet e drejtpërdrejta. Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit. Kjo realizohet nga pedagogët e lëndës dhe Sekretaria mësimore e programeve master.

SHLUJ UMB ka të dhëna të plota dhe statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik. Institucioni ka të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim. Të dhënat janë të regjistruara në Regjistrin Themeltar, në Regjistin e Indeksit, në Regjistrin e Rezultateve Akademike, në Regjistrimin e Diplomave. Të dhënat janë edhe në variantin elektronik. Të dhënat statistikore i raportohen MAS dhe rektoratit.

Standardet që lidhen me të drejtat e studentëve janë përmbushur plotësisht.

POLITIKA E KERKIMIT SHKENCOR.

- **Kërkimi shkencor**

Pjesa përshkrimore

SHLUJ Universiteti Marin Barleti ka një politikë të kërkimit dhe strukturat e posaçme të kërkimit për përmbushjen e kësaj politike. Në UMB funksionon Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit "Barleti" (BIRD) si dhe Instituti Shqiptar për Çështje Publike (AIPA). Institutet synojnë të realizojnë qëllimin e tyre nëpërmjet kryerjes së punës studimore e kërkimore, trajnimeve, kurseve e konsultave, shërbimeve, veprimtarisë botuese dhe realizimit të projekteve të nivelit të lartë në të mirë dhe interes të publikut. UMB ka krijuar hap pas hapi të gjithë infrastrukturën e nevojshme për të nxitur dhe mbështetur veprimtarinë kërkimore-shkencore ndërdisiplinore cilësore të strukturave të UMB-së, Instituteve. SHLUJ UMB, AIPA dhe BIRD synojnë të bashkëpunojnë me institucione të tjera kërkimore-shkencore si dhe agjencitë e zhvillimit në rajon e më gjerë për organizimin e veprimtarive të përbashkëta si dhe të bëhen pjesëmarrës aktiv në rrjetet ndërkombëtare të institucioneve të kërkimit dhe zhvillimit. Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit Barleti dhe Instituti Shqiptar për Çështje Publike janë ngritur posaçërisht për t'i shërbyer qëllimit kryesor të kërkimit, duke u bërë krahu kryesor i SHLUJ Universiteti Marin Barleti në këtë drejtim.

Institutet janë njësi të angazhuara tërësisht në kërkimin që fokusohet jo vetëm në organizimin e mirë dhe rritjen e kapaciteteve të Universitetit por edhe në krijimin e një mjedisi të angazhuar në kërkim brenda tyre, që mbështet përpjekjet kërkimore dhe gjenerimin e një tërësie rrethanash të volitshme për kërkimin në kontekstin e gjerë socio-ekonomik të Shqipërisë. Ato përpiqen që të ruajnë balancën në zhvillimin e trinomit arsim - kërkim - novacion, në përputhje me kriteret dhe standartet e BE-së.

Një ndër objektivat kryesore të Universitetit dhe Instituteve është realizimi, nëpërmjet stafit të brendshëm dhe atij të atashuar, i kërkimeve cilësore në fushat e veprimtarisë që mbulohen prej tyre, jo vetëm në bashkëpunim me njëri-tjetrin, por edhe me institucione të tjera kërkimore-shkencore brenda dhe jashtë vendit. Vetë stafi akademik i Universitetit Marin Barleti realizon punë kërkimore-shkencore kryesisht si staf i angazhuar pranë qendrave, departamenteve apo Instituteve, si punonjës kryesorë kërkimor-shkencorë, lektorë apo koordinatorë projektesh kërkimore.

Si pjesë e strategjisë kërkimore janë përcaktuar këto detyra për institutet e kërkimit**:**

- Hartojnë strategjitë kryesore të kërkimit dhe etikës në kërkim;
- Inkurajojnë krijimin e një gjenerate të re kërkuesish shkencor në fushat e politikave mjedisore, sociale dhe ekonomike;
- Inkurajojnë partneritetin dhe integrimin e të rinjve në komunitet, për gjetjen e alternativave që do të mundësojnë kohezionin social dhe zhvillimin e qendrueshëm;
- Marrin pjesë në programet që financojnë projekte kërkimi nga donatorë të ndryshëm brenda dhe jashtë vendit;
- Nxisin krijimin e një aleance të suksesshme midis aktorëve kryesorë në vend, për të mundësuar një dialog të vazhdueshëm midis tyre mbi reformat ekonomike dhe zhvillimin e integruar ekonomik në vend dhe më gjerë;
- Sjellin më afër komunitetin e biznesit me botën akademike, ofrojnë konsulencë dhe shërbime të drejtpërdrejta për komunitetin e biznesit, veçanërisht ato që lidhen me zhvillimin e SME-ve, teknologjinë e informacionit, kërkimin, zhvillimin, inovacionin si dhe ekonominë e bazuar në dije;

Kërkimi shkencor është një nga drejtimet kryesore të SHLUJ UMB i cili realizohet në përputhje me kriteret dhe standartet e EQUIS , sipas kategorive të mëposhtme:

- Kërkimi akademik - i cili ka si qëllim prodhimin dhe organizimin e dijes, zhvillimin e teorive të reja dhe promovimin e forcimin e veprimtarive kërkimore në shërbim të mjedisit akademik, të bazuara në metodologji të reja e të mirëfillta shkencore;
- Kërkimi i orientuar drejt praktikës - kërkimi që prodhon dije të reja dhe që kontribuon nga ana e tij në përparimit e efektshëm. Së bashku me praktikat në lidhje me çështje të ndryshme kjo kategori do të mbështetet nga metodologji të bazuara në vezhgime të thelluara dhe nga afër të situatave komplekse, raste studimore, anketime ose racionalizim të përvojës së akumuluar konsultative.
- Zhvillimi dhe inovacioni pedagogjik - ka të bëjë me futjen dhe përdorimin e metodologjive pedagogjike, mjeteve të edukimit dhe materialeve e teknikave mësimore inovative.

Studimet kërkimore shkencore në SHLUJ UMB kryhen në veçanti, në fushat e mëposhtme:
1) tregu i brendshëm;
2) kohezioni social;
3) siguria e ushqimit dhe konsumatorit;
4) zhvillimi i qëndrueshëm;
5) çështjet ekonomike dhe monetare;
6) rinia, edukimi dhe formimi profesional;

7) punësimi dhe çështjet sociale;
8) ndërmarrjet;
9) mjedisi;
10) marrëdhëniet me jashtë;
11) të drejtat e njeriut;
12) marrëdhëniet institucionale;
13) politikat dhe zhvillimet rajonale;
14) zhvillimi rural
15) çështjet gjinore

Në të gjitha kategoritë tematike të sipërpërmendura, veprimtaria kërkimore - shkencore synon të:

- trajtojë problemet kryesore që lidhen me interesat e drejtpërdrejta të të gjithë anëtarëve të shoqërisë;
- përdorë perspektivat ndërkombëtare krahasuese në edukim, duke zhvilluar vlerat e shanseve të barabarta dhe të mirën e përbashkët;
- kontribuojë në reformat në sektorin publik, në kuptimin e marrëdhënieve dhe lidhjeve midis teorisë dhe praktikës në arsimim, duke e vënë theksin në mënyrë të veçantë tek lidhja midis edukimit dhe çështjeve sociale;
- rrisë standardin e kërkimit duke:
    - promovuar standardet më të larta në cilësinë e kërkimit si edhe integritetin etik në punën kërkimore;
    - orientuar kërkimin në të gjitha fushat dhe kategoritë;
    - përcjellë debatet publike për edukimin nëpërmjet kontributit të pavarur të mbështetur në punën kërkimore duke mirëpritur dhe mbështetur partneritetin me agjencitë lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim që të promovojë të mirat publike në edukim;

Personeli akademik i SHLUJ UMB trajnohet në mënyrë të vazhdueshme dhe asistohet në realizimin e kualifikimeve brenda dhe jashtë institucionit, brenda dhe jashtë vendit, në lidhje me zhvillimet e fundit mbi kërkimin shkencor si dhe teknologjinë e kërkimit. E gjithë veprimtaria kërkimore si dhe kualifikimet e stafit pasqyrohen dhe do të vazhdojnë të pasqyrohen në azhornimin në mënyrë të vazhdueshme të kurrikulave të SHLUJ UMB.

Institutet mundësojnë formimin dhe trajnimin e studentëve të UMB nëpërmjet kurseve dhe moduleve të ofruara në fushat e veprimtarisë së qendrave kërkimore-shkencore te tij dhe strukturave të tjera të UMB. Gjithashtu studentët azhornohen me kërkimet më të fundit të realizuara nga SHLUJ UMB dhe Institutet nëpërmjet aktiviteteve të organizuara brenda dhe jashtë kampusit si dhe botimeve të ndryshme të cilët pasqyrojnë rezultatet e punës kërkimore.

Angazhimi në projektet e kërkimit dhe përgatitja e tezave në perfundim të studimeve Master, i aftëson ata për të qenë më të pavarur në gjetjen e zgjidhjeve dhe përballimin e kërkesave të një ekonomie inovative.

Universiteti dhe Institutet ofrojnë për studentët e të gjitha niveleve informacione për mundësitë që ofrohen për kualifikimin e tyre nga universitete dhe qendra të tjera kërkimore dhe shkencore brenda dhe jashtë vendit si dhe i mbështesin ata në procesin e aplikimit.

.

Studimet dhe hulumtimi i zhvilluar nga stafi akademik i UMB publikohen periodikisht në revistën "Gjeopolitika", në Revistën Studime Sociale, botim i Institutit të Sociologjisë si dhe në revista të tjera të

njohura ndërkombëtarisht. Revista "Gjeopolitika" publikohet një herë në tre muaj duke u fokusuar në çështje tematike të rëndësisë bashkëkohore. Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit "Barleti" është në proces të përgatitjes së një reviste tjetër shkencore që do të mbulojë fushat kryesore të veprimtarisë shkencore në UMB dhe do të mundësojë ndarjen e rezultateve të kërkimeve shkencore.

Tregues të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor (plotëso Tabelën 18)

Tregues të matshëm:

- ☑ Të dhëna për kërkimin shkencor (plotëso Tabelën 18)

Tabela 18

Aktivitete të planifikuara individuale dhe në rang Institucioni në vitet e fundit		
1.	Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL	7 botime monografike, apo me bashkautorësi – dy në vit; 6 numra të rinj revistash shkencore mbështetëse të programit – dy në vit; 40 artikuj të botuar në revista shkencore, brenda e jashtë Shqipërisë (dhjetë në vit)
2.	Numri i projekteve kërkimore të fituara	7 projekte të fituara, në të cilat janë përfshirë pedagogë të departamentit, si: Tempus, Migrimi ndërkombëtar i Shqiptarëve (sondazh); Interesi për të vazhduar studimet e larta (sondazh); Gratë në konflikt, etj.
3.	Numri i projekteve të zbatuara	7 projekte të zbatuara, në të cilat janë përfshirë pedagogë të departamentit
4.	Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL	9 (tre në vit)
5.	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda iAL	Të gjithë, 22 studentë dhe 7 pedagogë; në total mbi 100 studentë (bashkë me departamentet e tjera)
6.	Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor	Të gjithë studentët dhe pedagogët e këtij programi janë përfshirë në forma të ndryshme në kërkimin shkencor
7.	Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor	Të gjithë studentët dhe pedagogët e këtij programi janë përfshirë në forma të ndryshme në kërkimin shkencor
8.	Numri i Çmimeve Kombëtare	1 (një)

- Dokumentacioni Përkatës
- Marrëveshje të bashkëpunimit
- Dosje të veprimtarive kërkimore

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret		Vlerësimi për Kriteret dhe standardet
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.		
Kriteri 1 **Kriteri 2**	Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse; Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	Personeli akademik që mbulon Programi "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse. Kjo dëshmohet në dosjet personale, por edhe një të dhënat statistikore të SHLUJ UMB. Veprimtaria kërkimore e personelit akademik përbën një kontribut për zhvillimin e kërkimit të aplikuar në fushën e shkencave të edukimit.
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.		
Kriteri 1 **Kriteri 2**	Personeli akademik që angazhohet në mësimëdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj; Personeli akademik që angazhohet në mësimëdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.	Në këtë program ka dhënë mësim një pedagog i huaj nga Britania e Madhe.
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.		
Kriteri 1 **Kriteri 2**	Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor; Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.	SHLUJ UMB ka organizuar dy programe kualifikimi dhe zhvillimi profesional për personelin akademik të drejtuara nga prorektori për kërkimin dhe studimet pasuniversitare. Programet kanë patur si objekt aftësimin për përdorimin e metodologjisë bashkëkohore të mësimdhënies, për hartimin e programeve lëndore, për specifikat e mësimdhënies me të rriturrit, për njohjen me prirjet e zhvillimit të arsimit të lartë, për bashkëpunimin me biznesin. Në seancat e kualifikimit janë ftuar edhe pedagogët e jashtëm. Personeli akademik i SHLUJ UMB është mbështetur për kualifikime të mëtejshme brenda ose jashtë vendit. Disa pedagogë kanë fituar specializime jashtë vendit.
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.		
Kriteri 1 **Kriteri 2** **Kriteri 3**	Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi; Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi; Institucioni disponon një bazë të dhënash	SHLUJ UMB disponon të dhënat për studimet shkencore të pedagogëve të Programit "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit". Këto të dhëna përfshijnë pjesëmarrjen dhe kumtimet në konferenca, artikujt shkencorë. SHLUJ UMB disponon të dhënat për botimet e pedagogëve të Programit "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit". Të dhënat që disponohen për botimet përfshijnë tekste libra, monografi, artikuj apo kumtesa..

	për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.	SHLUJ UMB disponon të dhënat për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në Programin "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit".

Konkluzionet e vlerësimit:

SHLUJ UMB ka hartuar dhe zbaton një poltikë të kërkimit shkencor dhe ka ngritur strukturat që e mbështesin realizimin e kësaj politike. Kërkimi shkencor është një element i ngarkesës së pedagogëve në SHLUJ UMB. Tregues të veprimtarisë kërkimore janë konferencat shkencore, botimet në revista, kërkimet e dy instituteve kërkimore, punimet e studentëve të programeve master. Pedagogët kanë kryer kërkime të cilat i kanë prezantuar në konferencat e organizuara nga vetë institucioni ose në konferenca të organizuara nga institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. SHLUJ UMB publikon revistën „Gjeopolitika". SHLUJ UMB ka dy institute kërkimi të cilat bashkëpunojnë me programet MP duke transmetuar rezultatet e kërkimeve në veprimtari kërkimore, por edhe duke i kontribuar mësimdhënies. SHLUJ UMB zbaton një politikë të mirëpërcaktuar për kualifikimin e vazhdueshëm të personelit, e cila parashikon si trajnimet brenda institucionit, ashtu edhe kualifikimet dhe specializimet jashtë institucionit dhe jashtë vendit. SHLUJ UMB disponon një bazë të dhënash për veprimtarinë kërkimore shkencore të personelit. Kërkohet një integrim më i mirë i rezultateve të kërkimit të kryer nga institutet e UMB dhe personeli akademik me mësmidhënien.

Standardet për kërkimin shkencor janë përmbushur.

1. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

SHLUJ UMB ka përcaktuar një politikë bashkëpunimi me partnerë vendas dhe të huaj në dobi të përmbushjes së objektivave të programeve që ofron. SHLUJ UMB ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me këto institucione:

Marrëveshje me këto universitete:

- Universiteti " Universum", Kosovë,15 Prill 2007
- Universiteti për Biznes dhe Teknologji,Prishtinë, Kosovë, 7 Mars 2008
- Universiteti Shtetëror i Tetovës, Maqedoni, 7 Mars 2008
- Universiteti "Fama", Kosovë, 12 Janar 2009
- Universiteti Clemson,South Caroline, USA, 8 Mars 2010
- Universiteti Ibero-American (UNIBE), Rep.Domenikane, 8 Mars 2010
- Universiteti "Mahidol", Tailand, 8 Mars 2010
- Universiteti i Prishtines, Kosove,8 Mars 2010
- Universiteti "South Bohemia" , Rep. Çeke,8 Mars 2010
- Universiteti "Free State", Afrikë e Jugut, 8 Mars 2010
- Universiteti "Western Cape", Afrikë e Jugut, 8 Mars 2010
- Universiteti "Tallin", Estoni, 8 Mars 2010
- Universiteti Capital Normal, 14 Prill 2010
- Universiteti Cardiff, England,5 Maj 2010
- Universiteti i Udine-s, Fakulteti i Ekonomisë,Itali,22 Qershor 2010
- Universita Degli Studi di Genova,Italia 13.01.2015
- Universita Degli Studi Roma Tre, Italia 18.09.2014

- Instituti Teknologjik i Epirit 10.05.2014
- Lappeenranta University of Technology, Finland 01.08.2013
- Universita Degli Studi Roma Tre, Italia 26.06.2013
- University of Arkansas Clinton School 03.04.2013
- University of Studies of Bari, Italy 31.03.2013
- Il Politecnico di Bari (POLIBA), Italia 31.01.2013
- Instituto Nacionale di Architettura, Roma, Italia 31.07.2012
- AHLEI (American Hotel & Lodging Educational Institution) 27.02.2012
- Instituto Nacionale di Architettura INARCH, Lazzio, Italia 17.02.2012
- Pearson Language Tests, London, United Kingdom 25.01.2012
- Seconda Universita Degli Studi di Napoli, Italia 11.07.2011
- Bournville College, Birmingham United Kingdom 22.06.2011

MARRËVESHJE ME SHKOLLA DHE INSTITUCIONE SHQIPTARE

- Ministri për Çështjet Vendore 21.06.2014
- Veneto Banka Tiranë 30.04.2014
- Komiteti Shqiptar i Helsinkit 31.03.2014
- Ministria e Kulturës 27.03.2014
- Shkolla Shqiptare e Administratës Publike 19.03.2014
- Njësia Bashkiake nr 1 05.03.2014
- Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit 04.03.2014
- Akademia e Shkencave të Shqipërisë 03.07.2013
- Shega Trans 30.06.2013
- Marketing and Distribution Albania 30.06.2013
- Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqsorë 04.06.2013
- Avokati i Popullit 29.04.2013
- Qendra për Nisma Ligjore Qytetare 07.04.2013
- Linja e Këshillimit për Gra e Vajza 07.04.2013
- Aleanca Gjinore për Zhvillim 07.04.2013
- USAID/Rritje Albania 17.03.2013
- Unioni i Gjyqtarëve 31.10.2012
- Agjencia e Shërbimeve të Sporteve 15.02.2012
- Shkolla "Internacional," Vlorë 27.10.2011
- Gjimnazi "Nënshkruesi i Pavarësisë Nebi Sefa" 12.05.2011
- Gjimnazi "Dituria", Lushnje 12.05.2011
- Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës 03.06.2010
- Qendra Ndëruniversitare e Studimeve Albanologjike 07.01.2010
- Universiteti Bujqësor i Tiranës 25.11.2008
- Ministria PÇS, Shërbimi Kombëtar i Punësimit 19.12.2007
- Ministria e Brendshme, Dept. i Administratës Publike 12.12.2007
- Zyra e Avokatisë Kalo & Associates 20.03.2007
- Studio Ligjore Hakani & Associates 16.03.2007
- Instituti i Studimeve Publike dhe Ligjore 14.03.2007

Marrëveshje me universitetet e rajonit

- Memorandum bashkëpunimi me universitetin AAB Prishtinë
- Memorandum bashkëpunimi me universitetin Shtetëror të Tetovës
- Universitetin për Biznes dhe Teknologji të Prishtinës (UBT)
- Memorandum bashkëpunimi me universitetin Dardania Prishtinë.

Po kështu ka marrëshje me institucione brenda vendit si: Avokati i Popullit, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve, Instituti Europian i Tiranës, Instituti Shqiptar i Sociologjisë, Internacional Sociological Association-ISA, European Sociological Association, ESA Balkan sociological Forum, BSF, Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillimetj. SHLUJ UMB gjithashtu ka nënshkruar edhe marrëveshje bashkëpunimi më disa nga agjensitë e rëndësishme të punësimit. (Shih dosjen e marrëveshjeve)

Tregues të matshëm:

☑ Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (plotëso Tabelën 19)

Tabela 19

Aktivitete të planifikuara individuale dhe në rang Institucioni në dy vitet e fundit		
1.	Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL	2 Tekste mësimore 2 monografi 40 botime shkencore
2.	Numri i projekteve kërkimore të fituara	2 projekte të fituara (trajnimi i administratës lokale, Tempus)
3.	Numri i projekteve të zbatuara	2 projekte të zbatuara
4.	Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL	7 aktivite shkencore
5.	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda iAL	70 studentë të fakultetit , 8 anëtare të fakultetit, gjithsej
6.	Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor	Të gjithë studentët dhe pedagogët e këtij programi janë përfshirë në forma të ndryshme në kërkimin shkencor
7.	Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor	Të gjithë studentët dhe pedagogët e këtij programi janë përfshirë

		në forma të ndryshme në kërkimin shkencor
8.	Numri i Çmimeve Kombëtare	1

☑ Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (Plotëso Tabelën 20)

Tabela 20

Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese	
Institucionet qeveritare bashkëpunuese:	**Lloji i bashkëpunimit**
Avokati i popullit	Trajnime, monitorime, pjesëmarrje në projekte
Institucioni in Ekzekutimit të Vendimeve	Trajnime, monitorime, pjesëmarrje në projekte
Instituti Europian i Tiranës	Trajnime, monitorime, pjesëmarrje në projekte
Instituti Shqiptar i Sociologjisë	Aktivitetete të përbashkëta shkencore
UT, Fakulteti i Shkencave Sociale	Mësimdhënie, aktivitetete të përbashkëta shkencore
Universiteti A Moisiu Durrës	Mësimdhënie, aktivitetete të përbashkëta shkencore
Universiteti I Qemaili i Vlorës	Mësimdhënie, aktivitetete të përbashkëta shkencore
Universiteti Ndërkombëtar i Strugës	Mësimdhënie, aktivitetete të përbashkëta shkencore
UN Women	Projekte
Organizatat Profesionale:	
Internacional Sociological Association, ISA	Anëtarës të rregullt; Pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare
European Sociological Association, ESA	Anëtarësi; Pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare
Balkan sociological Forum, BSF	Anëtarësi; Pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare
Instituti Shqiptar i sociologjisë (AIS)	Partneritet, intershipe, konferenca shkencore; pjesëmarrje e studentëve në aktivitete dhe në projekte kërkimore.

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim	Trajnime, ekspertizë, intership
Qendra e Studimeve Ekonomike e Sociale (QSES)	Trajnime, ekspertizë, intership, pjesëmarrje e studentëve në realizim projektesh kërkimore
Komuniteti i biznesit, tregu i punës	
Instituti për demokraci e Ndërmjetësim (IDN)	Intership, vende pune për studentët
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim	Intership, vende pune për studentët
Qendra e Studimeve Ekonomike e Sociale (QSES)	Intership, vende pune për studentët

- Dokumentacioni përkatës
- Dosja e marrëveshjeve të bashkëpunimit
- Dosja e projekteve
- Dosje personale të personelit akademik
- Disjet e konferencave
- Revista Gjeopolitika

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret		**Vlerësimi për Kriteret dhe standardet**
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.		
Kriteri 1 **Kriteri 2**	Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve "Master Profesional", institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese; Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve "Master i Shkencave" ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.	SHLUJ UMB ka vendosur bashkëpunim me një sërë institucionesh arsimore për zhvillimin e praktikës. Marrëveshjet e nënshkruara të bashkëpunimit të SHLUJ UMB me një sërë institucionesh dëshmojnë institucionalizimin e bashkëpunimit për realizimin e praktikës profesionale.

Konkluzionet e vlerësimit:
GVBC konstaton se UMB ka një politikë të efektshme të marrëdhënieve të bashkëpunimit me partnerë jashtë institucionit. Bashkëpunimi i UMB me partneret rezulton të jetë një vlerë e shtuar për UMB në funksion të mësimit, kërkimit, praktikës dhe reputacionit. Standardet për bashkëpunimin janë përmbushur plotësisht.

- **PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME**

ANALIZA SWOT

Anët e forta

- **Ndërtimi i institucionit dhe programeve mbi bazën e një vizioni, misioni dhe plani të zhvillimit strategjik të qartë, të plotë, modern.** Dokumenti i Planit Strategjik të Zhvillimit të institucionit është një dokument që orienton drejt dhe me realizëm zhvillimin në kontekstin e institucionit, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.
- **Respektimi i kërkesave të legjislacionit parësor dhe dytësor** për ideimin, organizimin dhe administrimin e Programit "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit". Programi është konceptuar dhe administruar në përputhje me kërkesat ligjore dhe pedagogjike.
- **Zotërimi dhe përdorimi i një kornize rregullatore.** Korniza e plotë rregullatore e përgatitur dhe e zbatuar nga SHLUJ UMB ka mbështetur zbatimin e kërkesave të ligjit dhe ka ndikuar pozitivisht në orientimin dhe veprimin e programit në përputhje me strategjinë e zhvillimit të UMB, me vizionin dhe misionin e tij dhe me treguesit e profesionalizmit. Statuti i SHLUJ UMB, Rregullorja e SHLUJ UMB, Plani i zhvillimit strategjik të UMB, Politika e Vlerësimit të Brendshëm, Rregulloret e Studimeve të Programit "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit", Paketa e Praktikës, Paketa e Provës Finale, Planet mësimore, Programet lëndore, Politika e kërkimit, Politika e rekrutimit dëshmojnë për një veprimtari të institucionalizuar, të strukturuar dhe të standardizuar.
- **Programi** "**Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit" është një program bashkëkohor studimi i një cilësie të lartë.** Ky program vlerësohet si program që garanton përgatitjen e studentëve në përputhje me objektivat dhe profilin e përcaktuar. Ai është ndërtuar në përputhje me vizionin, misionin e institucionit, nevojat e tregut, objektivat e reformës së arsimit të lartë në vend dhe të Procesit të Bolonjës dhe ka të integruar përvojën më të mirë bashkëkohore të huaj dhe vendase.
- **Kombinimi i standardeve akademike me aplikimet e botës reale.** Programi i studimit respekton standardet akademike duke i lidhur ato me aplikimet në sektorin e arsimit.
- **Institucionalizimi i sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë** ka mbështetur sigurimin e cilësisë. Vlerësimi është bërë pjesë integrale e veprimtarisë së UMB dhe të Fakultetit të Shkencave Sociale. Ngritja e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, hartimi i politikës së vlerësimit, përcaktimi i procedurave, përgatitja e instrumenteve, menaxhimi i procesit të vlerësimit të brendshëm, trajnimi i personelit dhe i studentëve për të përmbushur rolin e vlerësuesit janë tregues që dëshmojnë për një sistem vlerësimi veprues.

- **Cilësia e personelit akademik.** SHLUJ UMB ka hartuar një politikë dhe ka ngritur një sistem për menaxhimin e personelit të institucionit që perfshin: politikën dhe procedurat e rekrutimit, politikën dhe procedurat e vlerësimit të performacës së personelit, politikën dhe procedurat e promovimit të personelit, politikën dhe procedurat e menaxhimit të të dhënave të personelit. Zbatimi i kësaj politike ka mundësuar punësimin e personelit cilësor në Programin "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit", maksimizimin e efektshmërisë së veprimtarisë së personelit dhe klimën pozitive të bashkëpunimit.
- **Infrastruktura moderne dhe funksionale ka mbështetur** realizimin me efektivitet të programit "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit".
- **Bashkëpunim i institucionalizuar me institucione homologe, institucione të administratës publike dhe organizata.** Nëpërmjet këtij bashkëpunimi SHLUJ UMB realizon objektivat për praktikën, kërkimin, ndarjen e përvojave dhe punësimin e të diplomuarve.
- **Baza e të dhënave për studentët dhe personelin akademik.** Zotërimi i të dhënave të regjistruara ka krijuar avantazhe për të mbajtur më shumë të dhëna, për t'i organizuar ato në mënyra të ndryshme, për t'i përdorur më lehtësisht nga të interesuarit.
- **Strukturë e kompletuar organizative dhe funksionale.** Krijimi i një strukture të kompletuar, i njësive koordinuese dhe të sigurimit të cilësisë kanë ndihmuar në një menaxhim më të efektshëm, delegim të detyrave dhe përmbushje më të mirë të misionit.
- **Klima pozitive e punës dhe e bashkëpunimit.** SHLUJ UMB ka një politikë të efektshme të marrëdhënieve të punës brenda institucionit dhe të marrëdhënieve të bashkëpunimit me partnerë jashtë institucionit. Klima e punës në UMB është bashkëpunuese, mbështetëse, komplementare. UMB garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të angazhuar në pozicione pune të ndryshme. Po ashtu bashkëpunimi i UMB me partneret rezulton të jetë një vlerë e shtuar në funksion të mësimit, kërkimit, reputacionit

Pika të dobëta

- **Integrimi i rezultateve të kërkimit në procesin mësimor**. Megjithë arritjet e deritanishme, vërehet se rezultatet e kërkimeve të SHLUJ UMB, të pedagogëve dhe të kërkimeve vendase mund të integrohen më mirë me mësimin.

- **Burime të kufizuara të periodikëve të huaj** në mbështetje të Programin "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit".

- **Përfshirja e kufizuar e studentëve në veprimtarinë kërkimore** të SHLUJ UMB.

Mundësitë

- **Angazhimi serioz i SHLUJ UMB dhe i FSHS** për të ndërtuar një program modern të drejtimit të arsimit.
- **Respektimi i standardeve të cilësisë.**
- **Kërkesat në rritje të tregut të punës për specialistë të politikave arsimore dhe drejtimit të arsimit.**
- **Reputacioni pozitiv i SHLUJ UMB** në publik.
- **Bashkëpunimi** me universitete të huaja për të njohur dhe zbatuar përvojat më të mira.

Pengesat:

- **Rritja e konkurrencës** si rezultat i ofrimit të programeve të drejtimit dhe administrimit të arsimit nga IAL-të e tjera në vend.
- **Numri i kufizuar i studentëve** që nuk justifikon një investim më të madh në teknologjinë mësimore në funksion të programit.

REKOMANDIME

- Do të ishte ndihmuese nëse do të bëhej një abonim vjetor në një nga bibliotekat që ofrojnë periodikë elektronikë nga fusha e arsimit.

- Të punohet për të integruar më mirë studentët në veprimtarinë kërkimore.

Ekipi i vlerësimit shpreson se ky raport do të kontribuojë në zhvillimin e mëtejshëm pozitiv të Programit "Master Profesional në Edukim me profil Drejtim dhe Administrim i Arsimit". Ekipi i vlerësimit shpreson se ky raport siguron një informacion të vlefshëm për vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin.
Ekipi i vlerësimit falënderon drejtuesit e SHLUJ UMB, pedagogët, personelin administrativ dhe studentët për bashkëpunimin që treguan për të realizuar këtë vlerësim.

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm

- Dr.Robert Gjedia
- Msc. Migena KAPLLANAJ
- PhD. Edita FINO
- Prof.Dr. Gëzim Hadaj
- Msc. Eurona LEKA
- Luesta METANI

SHTOJCA 1: TË DHËNA PËR PUNIMET E DIPLOMËS TË PROGRAMIT "MASTER PROFESIONAL NË EDUKIM ME PROFIL DREJTIM DHE ADMINISTRIM I ARSIMIT"

Nr.	Emer Mbiemer	Tema	Pedagogu	Grada Titulli	Fusha e ekespertizës
1	Suada Proda (Lepuroshi)	Cilësia e drejtimit të punës në shkollë	Saemira Pino	Dr.	Sociologji edukimi
2	Anila Kapllanaj	Konflikti mësues-nxënës për shkak të vlerësimit	Marjana Çadri	Dr.	Pedagogji
3	Valbona Sulcaj	Profesioni i mësuesit si profesion i rregulluar	Marenglen Spiro	Prof. Dr.	Administrim arsimi
4	Valentina Lamaj	Braktisja e fshehtë, problematika dhe zgjidhje	Lekë Sokoli	Dr.	Sociologji edukimi
5	Elmerina Sina	Konflikti mësues-nxënës për shkak të dallimeve sociale	Marjana Çadri	Dr.	Pedagogji

6	Mana Muça	Menaxhimi i konflikteve me nxënësit në shkollë	Marjana Çadri	Dr.	Pedagogji
7	Marek Gryn	Qëndrimet e mësuesve për integrimin e e nxënësve me aftësi të kufizuara	Marjana Çadri	Dr.	Pedagogji
8	Tanja Konomi	Efektshmëria e trajnimit të mësuesve	Marenglen Spiro	Prof. Dr.	Administrim arsimi
9	Enkelejda Koçiu	Problematika të përgatitjes ditore të mësuesve për mësim	Marjana Çadri	Dr.	Pedagogji
10	Albana Çela	Shkolla efektive (studim rasti)	Lekë Sokoli	Dr.	Sociologji edukimi
11	Klodiana Bushamau	Menaxhimi i braktisjes së shkollës	Lekë Sokoli	Dr.	Sociologji edukimi
12	Çeljeta Kila	Roli i komunikimit të brëndshëm në shkollë	Lekë Sokoli	Dr.	Sociologji edukimi
13	Lefteri Xhaferri	Problematika të përzgjedhjes së teksteve	Marenglen Spiro	Prof. Dr.	Administrim arsimi
14	Luesta Metani	Problematika të vendimmarrjes në shkollë	Saemira Pino	Dr.	Sociologji edukimi